



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 687/10 prot.

Datë 15.04.2025

V E N D I M

Nr. 512/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi

i operatorëve ekonomik “EC Pro Partners” SHPK & “Gjiguria” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK në procedurën mësipërme e prokurimit.

Ankimues:

BOE “Rilindje Tiefbau” SHPK me NIPT K83825601K
“Viante Konstruktion” SHPK me NIPT K47103804L dhe
“Lis Konstruktion” SHPK me NIPT K66613407H dhe adresë
Adresa: Lagjia nr. 2, pasuria 4/46+1-9, zona kadastrale 8582,
PogradecK63029402A dhe adresë Lagjia 8 Shkurti, Pallati 2
katësh, përball Gjimnazit Perikli Ikonomi, Fier.

BOE “Eral Construction Company” Sh.p.k me NIPT
K82230002K, & “K.M.K” Sh.p.k me NIPT: L78223801E &
“Caushi M” shpk, me NIPT: L88419801O dhe adresë
Ballsh Mallakstër, Bulevardi “rrapo Hekali”, shkalla 1, kati
1, z.kadastrale 1090, nr. Pasurie 7/9810

BOE “L.T.E Construction” SHPK me NIPT L78006801F &
“Ndregjoni” SHPK me NIPT K31329048I dhe adresë
Tiranë, Kashar, Rruga 3 Dëshmorët, Kompleksi Grand,
Apartamenti F-2-08, Kati 1

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë SH.A.
Rr.Muharrem Gega "Nd.24, Hy. 1, Gjirokaster

Subjekte të Interesuara:

BOE “EC Pro Partners” SHPK me NIPT J67902012U &
“Gjiguria” SHPK me NIPT J62903456H dhe adresë Tirane,
Farke SAUK Rruga "Hamdi Sina", Pallatet FZ Construction
(Prane Liqenit te Thate), Nd.5, H.14, Kati 1.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27-12-2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Nderim i ujesjellesave te

fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

II.2. Në datën 27-01-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

II.3. Në datën 28.02.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Eral construction company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk 175,851,880 lekë pa TVSH Skualifikuar
2. “SHENDELLI” SHPK 208,944,505 lekë pa tvsh skualifikuar
3. BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK 212,805,940.8 lekë pa tvsh skualifikuar
4. BOE “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK 219,527,503.6 lekë pa tvsh skualifikuar
5. BOE “EC Pro Partners” SHPK & “Gjiguria” SHPK 225,484,714 lekë pa tvsh kualifikuar
6. BOE AGI KONS SPK dhe Colombo SHPK 246,376,392.7 lekë pa tvsh skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik, më datë 05.03.2025, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraparak

II.5. Në datën 10.03.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.687/2025 protokoli, datë 11.03.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5122 e bashkimit të operatorëve ekonomik “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt ‘Ndertim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat , Bashkia Gjirokaster” me fond limit: 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK.

II.5.1.Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 687/1 prot., datë 11.03.2025.

II.6. Në datën 11.03.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 697/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5125 e bashkimit të operatorëve ekonomik “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk” SHPK si dhe me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “EC Pro Partners” SHPK & “Gjikuria” SHPK” SHPK.

II.6.1.Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 697/2 prot., datë 13.03.2025.

II.7 Në datën 11.03.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 698/2025 protokolli, datë 12.03.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5126 e bashkimit të operatorëve ekonomik “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK

II.7.1.Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 698/1 prot., datë 13.03.2025.

II.8. Me shkresën me nr. 687/2 prot., datë 20.03.2025 me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK, ankesën e BOE “Eral construction

company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk, ankesën e BOE “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II.9. Me shkresën me nr. 624 prot., datë 21.03.2025, me lëndë “Mbi trajtimin e ankesave të administruara pranë SHRUKGJ-së”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 687/3 prot., datë 26.03.2025, autoriteti kontraktor ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: *“[...]Më datë 19.03.2025 jemi njoftuar zyrtarisht nëpërmjet emailit dhe portalit e-albania se në sistem kanë ardhur 3 ankesa. Ne si AK në përfundim të afateve të ankimimit kemi bërë njoftimin e fituesit përfundimtar. Aktualisht jemi në pritje të përfundimit të 7 ditëve të pritjes së sigurimit të kontratës nga operatori ekonomik i shpallur fitues. Më datë 21.03.2025 duhet të kryhej në sistem Njoftimi i Lidhjes së Kontratës. Duke qënë në kushte të tilla kur ankesat kanë ardhur pasi ka kaluar afati i ankimimit, cilat janë hapat që AK duhet të ndjekë në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”.*

II.10. Me shkresën me datë 25.03.2025 me lëndë “Kërkse për informacion”, drejtuar autoriteti kontraktor, për dijeni Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 687/4 prot., datë 26.03.2025, BOE Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK ka paraqitur informacion shtesë lidhur me ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.11. Me shkresën me nr. 639 prot., datë 25.03.2025 me lëndë “Mbi trajtimin e ankesës së BOE Rilindja Tiefbau shpk, Viante Konstruksion dhe Lis Konstruksion SHPK të administruara pranë SHRUKGJ-së”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 687/5 prot., datë 28.03.2025, drejtuar BOE Rilindja Tiefbau shpk, Viante Konstruksion dhe Lis Konstruksion SHPK dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, ka informuar si vijon: *“[...] Duke u gjendur në kushte të tilla kur ankesa juaj ka ardhur pasi ka kaluar afati i ankimimit, i jemi drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës me nr. 624 prot., datë 21.03.2025 se cilat janë hapat që autoriteti kontraktor duhet të ndjekë në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, autoriteti kontraktor pasi të ketë marrë një përgjigje nga Komisioni i Prokurimit Publik do të shqyrtojë me vëmendje pretendimet tuaja dhe do të vijojë me vlerësimin e mëtejshëm të situatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

II.12. Me shkresën me nr. 2252/1 prot., datë 28.03.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 687/6 prot., datë 01.04.2025, drejtuar shoqërisë “Rilindja Tiefbau” SHPK dhe për dijeni autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

ka informuar si vijon: “[...] Në rastin konkret, referuar faqes zyrtare të internetit të KPP me adresë (<https://kpp.al>), rezulton se, operatori juaj ekonomik ka paraqitur ankesë në datë 10.03.2025 lidhur me vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës në këtë procedurë prokurimi. Në këto kushte, shoqëria juaj duhet të presë vendimin përkatës nga KPP, i cili, referuar nenit 24 të LPP, është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit.”

II.13. Me shkresën me nr. 764 prot., datë 07.04.2025 me lëndë “Lidhur me shqyrtimin e ankesave për procedurën e prokurimit me REF-34685-12-26-2024”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 687/7 prot., datë 09.04.2025, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastrë SH.A ka informuar se: “[...]Në këtë fazë të procedurës, ku nuk është i mundur pezullimi i saj, na rezulton i pamundur trajtimi i mëtejshëm i ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomik për shkak të mungesës së një vendimmarrjeje apo qëndrimi nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.”.

II.14. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK ka dorëzuar argumente në Sistemin e Ankesave Elektronike, protokolluar me nr. 697/1 prot., datë 12.03.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1 Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK nga procedura e prokurimit me arsyen se: “BOE “Rilindja tiefbau” Sh.p.k me NUIS: K83825601K, 3% e vleres se ofertuar, Lis Konstruktion Sh.p.k me NUIS: K66613407H 53% e vleres se ofertuar dhe Viante konstruktion 44% e vleres se ofertuar Oferte ekonomike 212,805,940.8 (dyqind e dymbedhjetë milion e tetqind e pesemijë e nenteqind e dyzet pike tete) leke pa tvsh.

Arsyet e skualifikimit:

I. Nuk ploteson piken 2.3.4 te DST. Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë si Drejtues Teknik në Licensën e kompanisë Inxhinierët si më poshtë:

a. Inxhinier Mjedisi 1 (një)

- b. Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- c. Inxhinier Hidroteknik 2 (dy)
- ç. Inxhinier Gjeolog 1 (një)
- dh. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- d. Inxhinier Elektrik 1 (një)

Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Ne VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit Publik” citohet shprehimisht: Neni 90 Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*
- t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*

- t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Pas verifikimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga BOE u konstatua se: Te shtojca 8, seksioni B:DEKLARATE Per nenkontraktoret dhe subjektet ne kapacitetet e te cilave do te mbeshtetet:*

Operatori Ekonomik (nese eshte e zbatueshme) OE Viante Konstruksion shpk deklarone; Ilirjan Kumaraku, me profesion dhe ne rolin e inxhinierit hidroteknik pa specifikuar nese ai është në rolin e Drejtuesit Teknik. Ndersa te shtojca 8 seksioni B:DEKLARATE Per disponimin e punonjesve dhe makinerive te nevojshme (nese kerkohen) OE Llazo shpk, i cili mbeshtet OE Viante Konstruksion shpk deklarone se disponon z. Ilirjan Kumaraku inxhinier hidroteknik ne rolin e Drejtuesit Teknik. Ne baze te deklarimeve te mesiperme nga OE Viante Konstruksion shpk dhe operatori mbeshtetes Llazo shpk konstatohet mosperputhje ne lidhje me rolin e inxhinierit hidroteknik Ilirjan Kumaraku si Drejtues Teknik.

Pra per sa me siper vleresojme se ne licencen e operatoreve ekonomik te BOE mungon nje inxhinier hidroteknik i cili duhet te jete drejtues teknik i punimeve.

Duke ju referuar ligjit sektorial te sektorit te zbatimit te punimeve ne ndertim konkretisht ne Vendimin nr.42, date 16.01.2008 «Per miratimin e rregullores per kriteret per procedurat e dhenies se licencave profesionale te Zbatimit , Klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve Juridike , qe ushtrojne Veprimari Ndertimi» , i ndryshuar parashikon se :Kreu I «Drejtues Teknik»- individi/et e diplomuar ne deget perkatese te universitetit qe eshte /jane pergjegjes/a per ndertimin e objektit sipas projektit dhe ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit , sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune brenda kushteve te kontrates».

• Ligji për Prokurimet Publike dhe standardet e zbatimit në ndërtim kërkojnë që për projektet komplekse, si objekti në fjalë, të angazhohen specialistë me licencë për të drejtuar punimet. Kjo është thelbësore për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e punimeve dhe për të përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.4 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë si Drejtues Teknik në Licensën e kompanisë Inxhinierët si më poshtë:

a. Inxhinier Mjedisi	1 (një)
b. Inxhinier Gjeodet	1 (një)
c. Inxhinier Hidroteknik	2 (dy)
ç. Inxhinier Gjeolog	1 (një))
dh. Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
d. Inxhinier Elektrik	1 (një)))

a) Per realizimin e punimeve objekt kontrate dy prej drejtuesve teknik te mesiperm duhet te jene te paisur me certefikate per Testimin e Preformances se Produkteve te Ndertimit, certifikata te jete leshuar nga institucione shteterore.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

• Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
• Inxhinier Mekanik	1 (një)
• Inxhinier Gjeoteknik	1 (një)

- Për stafin e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) Kontratë pune e vlefshme,

b) Diploma Universitare si dhe të figurojnë ne listë-pagesat e kompanisë, minimalisht për

periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

- Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

III.1.2. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.4 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

BEHET:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.4 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë si Drejtues Teknik në Licensën e kompanisë Inxhinierët si më poshtë:

- a. Inxhinier Mjedis **1 (një)**
- b. Inxhinier Gjeodet **1 (një)**
- c. Inxhinier Hidroteknik **2 (dy)**
- ç. Inxhinier Gjeolog **1 (një)**
- dh. Inxhinier Ndërtimi **1 (një)**
- d. Inxhinier Elektrik **1 (një)**

a) Per sa i perket kerkesave per stafin Drejtues Teknik në Licensën **Inxhinieri Gjeolog** mund të disponohet edhe me kontratë bashkëpunimi.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Gjeoteknik 1 (një)

- Për stafin e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) Kontratë pune e vlefshme,

b) Diploma Universitare si dhe të figurojnë në listë-pagesat e kompanisë, minimalisht për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

III.1.3. Në përmbushje të kriterëve më sipër BOE ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet shoqërive “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK, datë 27.01.2025 ku në nenin 3 “Pjesëmarrja” përcaktohet se: “pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: Rilindja Tiefbau shpk 3 % e totalit të punimeve, “Viante Konstruktion” SHPK 44 % e totalit të punimeve, Lis Konstruktion shpk 53 % e totalit të punimeve”;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Rilindja Tiefbau” SHPK;
- Licencën Nz. 5815/2, datë 20.03.2024;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Viante Konstruktion” SHPK;
- Licencën Nz. 4933/17, datë 05.06.2024;
- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Lis Konstruktion” SHPK;
- Licencën Nz. 3279/23, datë 19.12.2024;
- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Llazo” SHPK;
- Deklaratë angazhimi datë 27.01.2025 me anë të së cilës shoqëria “Llazo” SHPK deklaron se do të mbështesë shoqërinë “Viante Konstruktion” SHPK me drejtues teknike, kapacitete teknike, fuqi punëtorë;
- Licencën Nz. 4838/21, datë 21.08.2024;

III.1.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave

për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.5. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban

informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet

të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.7. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

III.1.8. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. 3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër. 4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin*

përgjegjësi solidarë për zbatimin e kontratës. 5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkojnë këto kapacitete, 19 atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. 6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit. 7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.1.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Rilindja Tiefbau” SHPK, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Viante Konstruktion” SHPK dhe të operatorit ekonomik “Lis Konstruktion” SHPK, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Llazo” SHPK të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të

fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 27.01.2025 të nënshkruar mes shoqërisë “Rilindja Tiefbau” SHPK, shoqërisë “Viante Konstruksion” SHPK dhe shoqërisë “Lis Konstruksion” SHPK përkatësisht në nenin 3 “Pjesëmarrja” rezulton, se pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: “Rilindja Tiefbau” SHPK 3 % e totalit të punimeve, “Viante Konstruksion” SHPK 44 % e totalit të punimeve, Lis Konstruksion SHPK 53 % e totalit të punimeve. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor kriteret e përcaktuara i konsideron si kusht për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto të fundit, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar se: **“2.3.4 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë si Drejtues Teknik në Licensën e kompanisë Inxhinierët si më poshtë:**
2.3.4 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë si Drejtues Teknik në Licensën e kompanisë Inxhinierët si më poshtë:

- a. Inxhinier Mjedisi **1 (një)**
- b. Inxhinier Gjeodet **1 (një)**
- c. Inxhinier Hidroteknik **2 (dy)**
- ç. Inxhinier Gjeolog **1 (një)**
- dh. Inxhinier Ndërtimi **1 (një)**
- d. Inxhinier Elektrik **1 (një)**

a) Per sa i perket kerkesave per stafin Drejtues Teknik në Licensën **Inxhinieri Gjeolog** mund të disponohet edhe me kontratë bashkëpunimi [...]”. Nisur nga arsyeja e skualifikimit Komisioni konstaton se, operatori ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE në Pjesën I, Seksioni B: Deklarata “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik (nëse është e zbatueshme) ka deklaruar që do të mbështetet tek subjekti “Llazo” SHPK për kapacitetet teknike (staf) dhe kapacitete teknike (makineri, pajisje, impiante) duke specifikuar konkretisht kapacitetin/et. Gjithashtu në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE në Pjesën III: Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, Seksioni B: Deklaratë “Deklarata “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, deklararon se: “disponon 56

punonjës mesatarisht për periudhën 3 muajt e fundit. Gjithashtu disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse/ profili i punojësve: ku ndër të tjera ka deklaruar znj. L. Xh, me profesion Ing. Hidroteknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin drejtues teknik-ing. Hidroteknik + ekspert sipas gjithë certifikimeve që disponon”. Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve në ofertën e paraqitur, ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë, “Viante Konstruktion” SHPK, ka marrë përsipër të kryejë në masën 44 % të totalit të punimeve zërat e preventivit, për të cilat është i nevojshëm punonjësi i specializuar inxhinier hidroteknik. Referuar kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.4. të kapacitetit teknik, KPP konstaton se numri i punonjësve të kërkuar për këto specialitete është 2 (dy). Në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh edhe pse punimet e zërave janë të ndarë në përqindje të caktuara, si dhe në kushtet kur në DST kërkohej 2 (dy) inxhinier hidroteknik (drejtues teknik në licencën e shoqërisë), rezulton se operatori ekonomik ka deklaruar znj. L. Xh. Në seksionin B: Deklaratë Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik (nëse është e zbatueshme) ka deklaruar se do të mbështetet në kapacitetet e operatorit ekonomik “Llazo” SHPK ku ndër të tjera ka specifikuar z. I. K, me profesion dhe në rolin e inxhinier hidroteknik. Gjithashtu referuar formularit përmbledhës të dorëzuar nga operatori ekonomik “Llazo” SHPK në seksionin B: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme nëse kërkohej ndër të tjera ka deklaruar z. I. K me profesion inxhinier hidroteknik, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e drejtuesit teknik, inxhinier hidroteknik. Nisur nga aryeja e skualifikimit, Komisioni gjykon se, në këto kushte anëtari i BOE “Viante Konstruktion” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar ka dhënë një indicie që plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.4. Autoriteti kontraktor duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik “Llazo” SHPK dhe operatorit ekonomik “Viante Konstruktion” SHPK lidhur me punonjësin e deklaruar z. I.K.

Sa më sipër pretendimi i Pretendimi i BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK qëndron.

III.2 Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK nga procedura e prokurimit me arsyen se: “III. Nuk plotëson pikën 2.3.5 të DST-se, për stafin mbështetës : Në Marrëveshjen e Bashkëpunimit të datë 27.01.2025 midis operatoreve ekonomike citohet se pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë

perkatesisht: “Rilindja tiefbau” Sh.p.k 3% e totalit te punimeve, Lis Konstruksion Sh.p.k 53% e totalit te punimeve dhe Viante Konstruksion 44% e totalit te punimeve. Rrjedhimisht kjo perqindje do te zbatohet edhe per pjesmarrjen e stafit mbeshtetes ne punime.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se:

a) Ne DST eshte kerkuar nje numer i caktuar punonjesish staf mbeshtetes si me poshte::

Teknik ndertimi 2(dy)

Teknik topograf 1(nje)

Karpentier 3(tre)

Murator 2(dy)

Saldator 2(dy)

Hekurkthyes 2(dy)

Specialist ndertimi 2(dy)

Suvatues 2(dy)

Hidraulik 4(kater)

Hidroizolues 2(dy)

Elektracist 2(dy)

Punonjes te konstruksioneve metalike 2(dy)

Shofer 4(kater)

Punetore te thjeshte 20(njezet)

Manovratore 3(tre)

Gjithsej 53(pesedhjetë e tre) punonjes

b) Sipas perqindjes Lis Konstruksion shpk (53%) duhet te deklaronte punonjes staf mbeshtetes si me poshte:

Teknik ndertimi 1(nje)

Teknik topograf 1(nje)

Karpentier 2(dy)

Murator 1(nje)

Saldator 1(nje)

Hekurkthyes 1(nje)

Specialist ndertimi 1(nje)

Suvatues 1(nje)

Hidraulik 2(dy)

Hidroizolues 1(nje)

Elektracist 1(nje)

Punonjes te konstruksioneve metalike 1(nje)

Shofer 2(dy)

Punetore te thjeshte 10(dhjetë)

Manovratore 2(dy)

Gjithsej 28(njezete e tete) punonjes

c)ne shtojcen nr.08 per permbushjen e pikes nr.2.3.5 te DST-se OE Lis Konstruksion shpk per punonjesit staf mbeshtetes te pikes a. deklararon:

Teknik ndertimi 1(nje)

Teknik topograf 1(nje)

Karpentier 1(nje)

Murator 0(zero)

Saldator 1(nje)

Hekurkthyes 0(zero)

Specialist ndertimi 1(nje)

Suvatues 0(zero)

Hidraulik 0(zero)

Hidroizolues 1(nje)

Elektracist 1(nje)

Punonjes te konstruksioneve metalike 1(nje)

Shofer 0(zero)

Punetore te thjeshte 8(tete)

Manovratore 0(zero)

Gjithsej 16(gjashtembedhjete) punonjes

Sipas te dhenave te deklaruar OE Lis Konstruksion i mungojne :

Karpentier 1 (nje)

Murator 1(nje)

Hekurkthyes 1(nje)

Suvatues 1(nje)

Hidraulik 2(dy)

Shofer 2(dy)

Punetori e thjeshte 2(dy)

Manovrator 2(dy)

Nga 53 punonjes staf mbeshtetes qe duhet te kete BOE, 28 punonjes duhet ti kete OE Lis konstruksion shpk sipas ndarjes ne perqindje ne marreveshje. Fakti qe OE ka deklaruar vetem 16 punonjes, eshte arsye per skualifikim.

III.2.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.5 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.5 Krahastafit teknik Operatoreset Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si me poshtë:

- | | |
|-------------------|---------|
| • Teknik Ndërtimi | 2 (dy) |
| • Teknik Topograf | 1 (një) |
| • Karpentier | 3 (tre) |
| • Murator | 2 (dy) |
| • Saldator | 2 (dy) |
| • Hekurkthyes | 2 (dy) |

- Specialist Ndërtimi 2 (dy)
- Suvatues 2 (dy)
- Hidraulike 4 (kater)
- Hidroizolues 2 (dy)
- Elektracist 2 (dy)
- Punonjës të konstruksioneve metalike 2 (dy)
- Shoferë 4 (katër)
- Punëtori e thjeshtë 20 (njetete)
- Manovrator 3 (tre)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Nr.Diplome /Nr.Amze
1					
2					
Etj.					

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH.”, i ndryshuar.
- Të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë, minimalisht për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Për Teknikun e Ndërtimit, Teknikun Topograf, duhet të paraqitet dëftesë e shkollës së mesme.

Për Manovrator/automakinistë/shoferë/buldozeristë, të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR. Në rastin kur punonjësit e mësipërm janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht për mjetet e marra me qira nga persona fizikë, nuk kërkohet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë.

Dokumentacioni (Diplomat/dëshmitë/certifikatat) që nuk janë lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimimit profesional, do të konsiderohen jo të sakta dhe bëhen shkak për veprime të mëtejshmesipas parashikimeve përkatëse të ligjit tëprokurimitpublik.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

III.2.2. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.3. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër BOE ankimes ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Rilindja Tiefbau” SHPK, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Viante Konstruktion” SHPK dhe të operatorit ekonomik “Lis Konstruktion” SHPK, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 27.01.2025 të nënshkruar mes shoqërisë “Rilindja Tiefbau” SHPK, shoqërisë “Viante Konstruktion” SHPK dhe shoqërisë “Lis Konstruktion” SHPK përkatësisht në nenin 3 “Pjesëmarrja” rezulton, se pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: “Rilindja Tiefbau” SHPK 3 % e totalit të punimeve, Viante Konstruktion SHPK 44 % e totalit të punimeve, Lis Konstruktion SHPK 53 % e totalit të punimeve. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor kriteret e përcaktuara i konsideron si kusht për përmbushjen e

kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto të fundit, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 27.01.2025 të nënshkruar mes shoqërisë “Rilindja Tiefbau” SHPK dhe shoqërisë “Viante Konstruktion” SHPK dhe shoqërisë “Lis Konstruktion” SHPK përkatësisht në nenin 3 “Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës rezulton, se do të jetë: Rilindja Tiefbau shpk 3 % e totalit të punimeve, shoqëria “Viante Konstruktion” SHPK 44 % të totalit të punimeve, “Lis Konstruktion” SHPK 53 % e totalit të punimeve. Gjithashtu në nenin 8 të kësaj marrëveshje “Përgjegjësia brenda bashkimit” është përcaktuar se: *“...Secili prej pjesëtarëve të këtij bashkimi operatorësh është individualisht dhe solidarisht bashkëpërgjegjës përballë autoriteti kontraktor dhe ligjit për çdo gjë që ka lidhje me kontratën objekt prokurimi. Secili prej pjesëtarëve të këtij bashkimi, në rast nevojë dhe në rast se ka mundësi, vë në dispozicion të pjesëtarëve të tjerë të këtij bashkimi, kapacitetet e tepërta apo të lira të çdo lloji që ai mund të disponojë gjatë fazës së realizimit të punimeve në varësi të natyrës së punimeve që do të kryhen në momenti e lindjes së nevojës (mjete, pajisje, makineri, fuqi punëtore, specialistë, staf teknik, kapacitetet financiare etj që do të konsiderohen të nevojshme nga ndonjë prej pjesëtarëve të bashkimit)”*. Akoma më tej, referuar listës së çmimeve sipas zërave të preventivit rezulton, se zërat si F.V tuba rakorderi ujësjellës, gërmim shkëmbi mesatar me cekic me eskavator me zinxhir, shtresë cakelli mbeturine kave, nënshtresë zhavorri, I.B.3 rrethimi i kaptanit zhulat zërat si gërmim shkëmbi mesatar me cekic me eskavator me zinxhirë, kollona b/a monolite C-16/20, h 4m, themel e xokol butobetoni C 12/15, zëri I.B.a ndërtim depo uji 100 m3, nr. 1 zhulat, shuma 4, I.B.5 dhoma e manovrimit + klorinimit depo uji nr. 1 zhulat, shuma 11, zëri I.B.12 Dhoma e manovrimit klorinimit Depo uji nr.2 zhulat, shuma 12, I.B.13 Rrethimi i depos Depo nr2 zhulat, shuma 13 I.B.14 Pusetë hyrje për depon depo nr. 2 zhulat, shuma 14 I.B.15 Rruga b/a për në depo depo nr. , zhulat, shuma 15 I.B.16 rrjeti ajror T.U me kabëll tip “ABC” depo nr. 2 zhulat, shuma 16 I.B.17 Punime elektrike depo nr. 2 zhulat, shuma 18 I.B.19 Tubacionet për Linjat e dërgimit zhulat, shuma 19, I.B.20 vepra ndërtimi për kalimin e tubacionit zhulat, shuma 20, I.B.21 pusetat, ajruesit, shkarkuesit zhulat, shuma 21, I.B.22 punime ndërtimi për rrjetet e brendshme zhulat, shuma 22, I.B.23 tubacionet për rrjetet e brndshme zhulat, shuma 23, I.B.24 Rruga b/a dhe cakull që do të riparohen zhulat (L = 2228 ml cakull + zhavorr, shuma 24 I.B.25 matësa uji elektromagnetik DN 100 në dalje të depove zhulat, shuma 25 I.B.26 Lidhjet e abonentëve zhulat do të realizohen nga operatori ekonomik “Lis Konstruktion” shpk. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar, se në interpretim të nenit 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, jemi përballë rastit ku autoriteti kontraktor kriteret e përcaktuara i konsideron si kusht për përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe këto të fundit, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e

kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të dokumenteve standarde të tenderit, operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE në Pjesën III: Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit, Seksioni B: Deklarata “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt-kontrate” deklaroi se disponon 70 punonjës mesatarisht për periudhën 3 muajt e fundit, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: z. J. T, me profesion inxhinier ndërtimi (profili infrastrukturë-transport) i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit teknik, inxhinier ndërtimi (profili infrastrukturë-transport), z. B. M, me profesion inxhinier gjeolog, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e drejtuesit teknik, inxhinier gjeolog, + ekspert sipas certifikimeve që disponon: ing. materialësh (specilist testimi performance mat ndërtimi) ekspert i punëve në lartësi, kordinator për sigurinë dhe shëndetin në punë, përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë për riskun e lartë, përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë Iso 9001:2015, përgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin e dëmeve në mjedis, specialist për organizimin dhe menaxhimin e kantiereve të ndërtimit, ekspert/përgjegjës për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, ekspert privat zjarrëfikës, manovrator, automakinist etj., Z. V. M me profesion teknik ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e teknik ndërtimi. Z. F.F me profesion ing. Teknik topograf, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e ing. Teknik teknik topograf. Z. L. A, me profesion karpentier i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e karpentier. Z. H. J, me profesion saldator, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e saldator. Z. Q.T me profesion hidroizolues i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin hidroizolues., z. C. H me profesion specialist ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e specialist ndërtimi, z. M. T, me profesion elektrikist, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e elektrikistit, z. S. K, me profesion Konstruksione metalike-montator, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin konstruksione metalike-montator. Z. Q. H i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e punëtor ndërtimi/specialist, z.D. M, i punësuar pranë shoqërisë në rolin e punëtor ndërtimi/specialist, z. Dritan Murati i punësuar pranë shoqërisë në rolin e punëtor ndërtimi/specialist, z. H. H i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e punëtor ndërtimi/specialist, z. Sh. R i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e punëtor ndërtimi/specialist, z. E.O i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e punëtor ndërtimi/specialist, z. L.B, i punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e punëtor ndërtimi/specialist, z. S. Gj i punësuar pranë shoqërisë në rolin e punëtor/ndërtimi/specialist. Ndërkohë referuar marrëveshjes se bashkëpunimit datë 27.01.2025 operatori ekonomik “Lis Konstruksion”, SHPK ka si pjesëmarrje në zbatimin e kontratës 53 % të totalit të punimeve, nisur dhe nga numri total i punonjësve të kërkuar nga autoriteti kontraktor 53 punonjës, rezulton se sipas pjesëmarrjes në bashkëpunim operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK duhet të deklaronte në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit 28 punonjës. Akoma më tej referuar zërave të preventivit sipas punimeve që do të kryejë operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK rezulton se do të kryejë punime si tubacione, për të cilat nevojitet punonjësi hidraulik i cili nuk është deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Sa më sipër arsyetuar BOE nuk e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit as sipas numrit të punonjësve të deklaruar dhe as sipas profilit të tyre.

Referuar pretendimit të BOE ankimues se ndodhemi në kushtet e vendimit nr. 279/2025, datë 25.02.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik sipas të cilit KPP ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit, Komisioni thekson se referuar vendimit nr. 279/2025 dhe kërkesës së autoritetit kontraktor për “punëtor ndërtimi dhe profesione të lidhura me to”, është konstatuar paqartësi në hartimin e dst konkretisht citoj: “...Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor përse i përket pikës 2.3.3/b dhe përkufizimit të “Punëtor ndërtimi dhe profesione të lidhura me to” sipas Vendimit Nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, vërehet se në këtë përkufizim janë të përfshirë edhe betonues dhe të tjerë që lidhen me to dhe karpentierë/zdrukthëtarë dhe të tjerë të lidhur me të. Autoriteti kontraktor në lidhje me hartimin e kriterit për punëtorët e ndërtimit dhe profesione të lidhura me to, nuk ka përcaktuar se cilën nga nëndarjet e profesioneve të këtij klasifikimi ka kërkuar, si dhe në procesverbal argumentimi nuk ka mirë argumentuar rolin e secilit profesion apo proceset e punëve që do të kryejse secili. Pra, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e stafit teknik dhe punonjës të specializuar/kualifikuar, për “Punëtorë ndërtimi dhe profesione të lidhura me to” dhe njëkohësisht edhe kërkesa e përsëritur për “betonues” dhe “karpentierë”, të cilat përfshihen në “grupin e puntorëve të ndërtimit”, krijojnë konfuzion në përmbushjen e numrit të tyre, pasi të treja këto profesione futen në të njëjtën klasifikim”, ndërsa referuar procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar ndarjet e punonjësve të kërkuar, duke përcaktuar kategoritë përkatëse.

Sa më sipër pretendimi i BOE Rilindja Tiefbau” SHPK, “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Lis Konstruksion” SHPK ankimues nuk qëndron.

III.3 Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK, “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Lis Konstruksion” SHPK: “Në përputhje me pikën 2.3.6.i, të tabelës së disponueshmërisë së mjeteve dhe makinerive ne DST, kërkohet që operatori ekonomik (OE) të disponojë "aparaturë për test presioni tubash" OE Viante Konstruksion shpk ne shtojcen 8 seksioni C:DEKLARATE “Per disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive te nevojshme per realizimim e punimeve objekt kontrate” ka deklaruar se disponon: 1(një) pajisje për matjen e presionit të ujit/ekuivalent barometer.

Duke patur parasysh se:

- pajisja për matjen e presionit të ujit/ekuivalent barometer eshte nje pajisje dore qe sherben per matjen e presionit ne pika te ndryshme te rrjetit.
- aparatura për test presioni tubash eshte nje pajisje specifike me disa pjese perberese(depozita e ujit, kompjuter, pajisje testimi) qe sherben per te bere te mundur testimin e presionit ne rrjet pasi eshte ai ndertuar , para se te vendoset ne funksion. ne gjykojme se pajisja e deklaruar nga ana e OE Viante Konstruksion shpk nuk perputhet me pajisjen e kerkuar ne DST.

Per sa me siper kjo eshte arsye per skualifikimin e BOE.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.6 i autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

i. *Operatorët Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:*

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	në pronësi ose me qira	copë	3
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	në pronësi ose me qira	copë	2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nga 1 deri në 3 ton	në pronësi ose me qira	copë	2
4	Makineri Prerëse/Asfalti	në pronësi ose me qira	copë	1
5	Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1
6	Minieskavator	në pronësi ose me qira	copë	2
7	Fadromë me goma (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1
8	Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	copë	1
9	Trencher për hapje kanali	në pronësi ose me qira	copë	1
10	Grejder (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1
11	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	copë	1
12	Autobot Uji	në pronësi ose me qira	cope	1
13	Autobetonjerë	në pronësi ose me qira	copë	2
14	Rul vibrues Gomë-Hekur me kapacitet mbi 12 ton	në pronësi ose me qira	copë	1
15	Autopompë Betoni	në pronësi ose me qira	copë	2
16	Vibrator Betoni	në pronësi ose me qira	copë	2

17	Betoniere te vogla	në pronësi ose me qira	copë	2
18	GPS	në pronësi ose me qira	copë	1
19	Kontenier Stacioner (zyra, ndërresa)	në pronësi ose me qira	copë	1
20	Sondë për shpim Pusesh	në pronësi ose me qira	copë	1
21	Betoforma	në pronësi ose me qira	m ²	200
22	Kokore	në pronësi ose me qira	copë	50
23	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	në pronësi ose me qira	copë	1
24	Jelekë fosforeshentë	në pronësi ose me qira	copë	50
25	Matrapik	në pronësi ose me qira	copë	1
26	Aparat për kthim hekuri, Tranxhë hekuri	në pronësi ose me qira	copë	2
27	Gjenerator	në pronësi ose me qira	copë	1
28	Depozita uji minimumi 5000 litra	në pronësi ose me qira	copë	2
29	Aparaturë për test presioni tubash	në pronësi ose me qira	copë	1

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës të DST-ve, duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qartë për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Për mjete të marra me qira/kontratë bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë/ bashkëpunimit.
- **Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira/Kontratë bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/ Kontratë Bashkëpunimi.

- Për autobitumatriçen të paraqitet certifikatë për transport lëndësh të rrezikshme.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

III.3.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK “Viante Konstruksion” shpk dhe “Lis konstruksion” SHPK K, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet shoqërive “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK, datë 27.01.2025 ku në nenin 3 “Pjesëmarrja” përcaktohet se: “pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: Rilindja Tiefbau shpk 3 % e totalit të punimeve, “Viante Konstruksion” SHPK 44 % e totalit të punimeve, Lis Konstruksion shpk 53 % e totalit të punimeve”;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Rilindja Tiefbau” SHPK;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK;
- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK;
- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Llazo” SHPK;
- Deklaratë angazhimi datë 27.01.2025 me anë të së cilës shoqëria “Llazo” SHPK deklaronte se do të mbështesë shoqërinë “Viante Konstruksion” SHPK me drejtues teknike, kapacitete teknike, fuqi punëtorë;

III.3.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se

operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,

autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërket të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit

26 të, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.3.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.6. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.6. (i) për disponimin e mjeteve, konstatohet se ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar Aparaturë për test presioni tubash. Nisur nga arsyet e skualifikimit, për plotësimin e këtij kriteri, anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik “*Viante Konstruktion*” SHPK ka dorëzuar, në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku në pjesën e tretë të tij Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ndër të tjera operatori ekonomik ka deklaruar se disponon pajisjen: pajisje për matjen e presionit të ujit/ekuivalent barometër me qira, deklaratë doganore/zhdoganim,

R 7103 datë 04.05.2023 kontratë qiraje me nr. rep.***, nr. kol ***, me afat të kontratës së qirasë 26.07.2024-25.07.2030.

III.3.7. Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterëve të mësipërme operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik. KPP gjykon se, legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, por dhe vetë ky i fundit ka rezervuar në kriterin e veçantë të kualifikimit edhe të drejtën e verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ka dhënë një indicie për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit lidhur me disponimin e mjeteve.

Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në këtë fazë të procedurës së prokurimit Komisioni gjykon se, anëtar i BOE “Viante Konstruktion” SHPK ka dhënë një indicie që plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit. Në këto kushte autoriteti kontraktor duhet të kërkonte sqarime BOE lidhur me pajisjen e deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në këtë fazë të procedurës së prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK dhe “Viante Konstruktion” SHPK dhe “Lis Konstruktion” SHPK ankimues qëndron pjesërisht.

III.4 Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK, “Viante Konstruktion” SHPK dhe “Lis Konstruktion” SHPK: *“Nuk plotëson piken 2.3.9 në DST e cila citon shprehimisht:*

Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë Nje (1) impiant prodhimi inerte Nje (1) impiant prodhimi betoni Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit, në rast se është në pronësi, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve. Viante Konstruksion shpk ka cituar në shtojcën nr. 8 se disponon dokumentacion pronesie për impiantin e prodhimit të inerteve dhe betonit, por nuk ka ngarkuar ne SPE asnjë dokument te tille.Mos plotesimi i ketij kriteri perben arsye per skualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.9 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë:

a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit, në rast se është në pronësi, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij.

Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve.

III.4.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK dhe “Viante Konstruksion” shpk dhe “Lis Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet shoqërive “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK, datë 27.01.2025 ku në nenin 3 “Pjesëmarrja” përcaktohet se: “pjesëmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë: Rilindja Tiefbau shpk 3 % e totalit të punimeve, “Viante Konstruksion” SHPK 44 % e totalit të punimeve, Lis Konstruksion shpk 53 % e totalit të punimeve”;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Rilindja Tiefbau” SHPK;
- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK;
- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK;
- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Llazo”SHPK;

- Deklaratë angazhimi datë 27.01.2025 ma anë të së cilës shoqëria “Llazo” SHPK deklaron se do të mbështesë shoqërinë “Viante Konstruksion” SHPK me drejtues teknike, kapacitete teknike, fuqi punëtorë.

III.4.3. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose

në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.4.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi¹⁹; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet*

teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi; l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.4.5. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.9 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: “Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë:

a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte

b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit, në rast se është në pronësi, duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij.

*Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve. Nisur nga arsyet e skualifikimit, për plotësimin e këtij kriteri, anëtar i BOE “Viante Konstruktion” SHPK ka dorëzuar, në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku në pjesën e tretë të tij Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate, ka deklaruar se disponon me qira mjetin Nyje Betoni dhe Nyje Inertesh, dokumentacion QKL+dok.pronësie+leje+deklaratë doganore etj, PN-2307-03-2016, kontratë qiraje me shoqërinë “Beladi” shpk me nr. rep. ***, nr. kol. ***, afati i kontratës së qirasë 26.02.2024-25.02.2030.*

Gjithashtu referuar nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në pikën 2 (i) parashikohet shprehimisht: “2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; Ndërsa në pikën 6 të po këtij neni parashikohet se: “6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.....Në këto kushte Komisioni gjykon se kemi të bëjmë me mjete konkretisht impiant inerte dhe impiant betoni. Referuar bazës ligjore të sipërcituar në këtë fazë të procedurës së prokurimit disponimi i mjeteve përmbushen me dorëzimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik “Viante Konstruktion” SHPK ka dorëzuar në SPE Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe ka deklaruar që disponon pajisjen nyjë betoni dhe nyje inertesh. Komisioni gjykon se, në këtë fazë të procedurës së prokurimit kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.9 përmbushet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në përputhje me nenin 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK, “Viante Konstruktion” SHPK dhe “Lis Konstruktion” SHPK ankimues qëndron.

III.5 Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK: *“I. Nuk ploteson piken 2.2.1 të DST të kriteret e vecanta të kualifikimit Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën 1 një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet. Pas verifikimeve në sistem të dokumentacionit të paraqitur nga BOE u konstatua se xhiro e tre viteve të fundit për OE Caushaj është më e vogël se 50%. Mos plotesimin e këtij kriteri e konsiderojmë arsye për skualifikim. “*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1 Në kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.2.1 autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2.2.1. *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën 1 një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet.*

III.5.2 Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK, në përmbushje të kriterëve sa më sipër, ka dorëzuar:

- Marrëveshje bashkëpunimi për bashkimin e operatorëve ekonomikë me nr. 412 prot, datë 24.01.2025 ku në nenin 3 “pjesëmarrja” përcaktohet se: *“Pala e parë shoqëria “Eral Construction Company” SHPK merr përsipër të kryejë 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara. Pala e dytë shoqëria “K.M.K” shpk merr përsipër të kryejë 25 (njëzet e pesë) % të vlerës së përgjithshme të tenderuara, pala e tretë shoqëria “Caushi-M” shpk merr përsipër të kryejë 25 (njëzet e pesë) % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara....”*
- Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nr. T11885241, datë 15.11.2024 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për operatorin ekonomik “Caushi M” SHPK;
- Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nr. T12294166, datë 22.01.2025 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për operatorin ekonomik “Eral Construction Company” SHPK;
- Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nr. T11466721, datë 23.09.2024 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për operatorin ekonomik “K.M.K” SHPK;

III.5.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të*

ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.4. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”. 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...]. 6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.5.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.6 Nisur nga arsyeja e skualifikimit të BOE “Eral Construction Company” SHPK & “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK me arsyetimin se operatori ekonomik “Caushi M” SHPK nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.2.1 pasi xhiro e tre viteve të fundit për OE “Caushi M” SHPK është më e vogël se 50%, ku në pikën 2.2.1 të kriterëve të veçnata të kualifikimit ka përcaktuar shprehimisht se: *“2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën 1 një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet”*, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK, konstaton se, ky i fundit ka dorëzuar Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nr. T11885241, datë 15.11.2024 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për operatorin ekonomik “Caushi M” SHPK, Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nr. T12294166, datë 22.01.2025 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për operatorin ekonomik “Eral Construction Company” SHPK, Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit nr. T11466721, datë 23.09.2024 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për operatorin ekonomik “K.M.K” SHPK, si dhe marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 24.01.2025 të nënshkruar mes shoqërisë “Eral Construction Company” SHPK dhe shoqërisë “K.M.K” SHPK dhe shoqërisë “Caushi M” SHPK përkatësisht në nenin 3 “Pjesëmarrja”, pjesëmarrja në zbatimin e kontratës rezulton, se do të jetë: “Eral Construction Company” shpk 50 % e totalit të punimeve, shoqëria “K.M.K” SHPK 25 % të totalit të punimeve, “Caushi M” SHPK 25 % e totalit të punimeve. Konkretisht referuar fondit limit të procedurës së prokurimit 248,188,809.9 (dyqind e dyzetë e tetë milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntë pikë nëntë) Lekë, pa TVSH, rezulton se sipas kriterit të veçantë të kualifikimit operatorët ekonomik duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën 1 një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet, pra jo më e vogël se 124,094,404.95. Nga ana tjetër operatori ekonomik “Caushi M” SHPK ka marrë pjesë në procedurën e bashkëpunimit si bashkim operatorësh, ku referuar marrëveshjes së bashkëpunimit të datës 25.01.2025 ky operator ka marrë përsipër të kryejë 25 % të vlerës së përgjithshme të punimeve. Mbështetur në përcaktimet

e pikës 3 të nenit 88 të VKM ku parashikohet se: “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, sipas arsytimit të mësipërm rezulton se operatori ekonomik “Caushi M” SHPK në përmbushje të kriterit të sipërcituar duhet të rezultojë me një xhiro vjetore në një nga vitet e periudhës së kërkuar 2021, 2022, 2023 të jetë jo më të vogël se 31,023,601.2 lekë pa tvsh. Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga bashkimi operatori ekonomik “Eral Construction Company” SHPK dhe shoqërisë “K.M.K” SHPK dhe shoqërisë “Caushi M” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka dorëzuar vërtetimet e listuara në pikën III.5.2 të këtij vendimi. Pra, që të quhet i përmbushur kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “Caushi M” SHPK duhet të plotësonte kërkesën e autoritetit kontraktor për të paktën një vit nga tre vitet e fundit, dhe referuar Vërtetim nr. T11885241, datë 15.11.2024 lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Rajonale e Tatimeve Tiranë në emër të “Caushi M” SHPK rezulton se për vitin 2021 vlera e xhiros është 73,570,202 lekë për vitin 2022 vlera e xhiros rezulton të jetë 57,478,654 lekë për vitin 2023 rezulton 93,050,736 lekë. Operatori ekonomik “Caushi M” SHPK e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën shtojcën 7, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK qëndron.

III.6 Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK: *“II. 2.3.8 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me: Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), sëbashku me aktin e miratimit.*

OE K.M.K – Ky operator ekonomik ofertues pjese e BOE nuk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) akt-miratimin për licencën (LN-4498-07-2022, Date 26.07.2022) me Kod III.2.B, e kërkuar në pikën 2.3.8 të DST-së. Mungesa e Akt-Miratimit, përbën një shkelje të kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhojë, është arsye për skualifikimin e BOE-së.

OE CAUSHI M shpk – Ky operator ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE asnjë dokument që vërteton përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 2.3.8 të DST-së, lidhur me licencën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta inerte, pra nuk ka ngarkuar licencën Kodi III.2.B dhe akt-miratimin. Mungesa e këtij dokumenti përbën arsye për skualifikimin e BOE-së.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.8 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.8 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me:

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) **Kodi III. 2. B** “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), së bashku me aktin e miratimit.

III.6.1. Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Marrëveshje bashkëpunimi për bashkimin e operatorëve ekonomikë me nr. 412 prot, datë 24.01.2025 ku në nenin 3 “pjesëmarrja” përcaktohet se: “Pala e parë shoqëria “Eral Construction Company” SHPK merr përsipër të kryejë 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së përgjithshme së punimeve të tenderuara. Pala e dytë shoqëria “K.M.K” shpk merr përsipër të kryejë 25 (njëzet e pesë) % të vlerës së përgjithshme të tenderuara, pala e tretë shoqëria “Caushi-M” shpk merr përsipër të kryejë 25 (njëzet e pesë) % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara....”
- Licencë LN-4498-07-2022, lëshuar nga QKB në emër të K.M.K shpk, me kodi III.2.B, data e lëshimit 26.07.2022 dhe emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim dhe transporti i dherave ose shtufe. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”.
- Licencë LN-7599-06-2019, lëshuar nga QKB në emër të Eral Construction Company shpk, kodi III.2.B, data e lëshimit 25.06.2019, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim, transportim i mbetjeve inerte, dhera dhe shtuf. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”. Bashkëlidhur akti i miratimi, licencë e kategorisë III.2.B, me nr. 5981 prot., datë 25.06.2019.

III.6.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim

të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.6.4. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së

parashikuar të marrëveshjes kuadër 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.6.5. Në nenin 39 pika 6 germa a) “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose....”

III.6.7. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”. Ky ligj përcakton: a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktajnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë; b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

III.6.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni

verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka për detyrë të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.6.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK “, Komisioni konstaton, se bashkimi i operatorëve ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin: Licencë LN-4498-07-2022, lëshuar nga QKB në emër të K.M.K shpk, me kodi III.2.B, data e lëshimit 26.07.2022 dhe emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim dhe transporti i dherave ose shtufe. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”. Licencë LN-7599-06-2019, lëshuar nga QKB në emër të shoqërisë “Eral Construction Company” shpk, kodi III.2.B, data e lëshimit 25.06.2019, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim, transportim i mbetjeve inerte, dhera dhe shtuf. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”. Bashkëlidhur akti i miratimi, licencë e kategorisë III.2.B, me nr. 5981 prot., datë 25.06.2019.

III.6.10 Referuar arsyetimit të autoritetit kontraktor rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK, është s’kualifikuar për mospërmbushje të kërkesës, nga anëtari i bashkimi të operatorëve “KMK” sh.p.k dhe “Caushi M” shpk me arsyetimin se: *Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me: Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), sëbashku me aktin e miratimit.*

OE K.M.K – Ky operator ekonomik ofertues pjese e BOE nuk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) akt-miratimin për licencën (LN-4498-07-2022, Date 26.07.2022) me Kod III.2.B, e kërkuar në pikën 2.3.8 të DST-së. Mungesa e Akt-Miratimit, përbën një shkelje të kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhojë, është arsye për skualifikimin e BOE-së.

OE CAUSHI M shpk – Ky operator ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE asnjë dokument që vërteton përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 2.3.8 të DST-së, lidhur me licencën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta inerte, pra nuk ka ngarkuar licencën Kodi III.2.B dhe akt-miratimin. Mungesa e këtij dokumenti përbën arsye për skualifikimin e BOE-së. Referuar dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.8 ndër të tjera ka përcaktuar se: “2.3.8 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me: Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), së bashku me aktin e miratimit.”

Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret BOE “Eral Konstruksion Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k dhe “Caushi M” shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Marrëveshje bashkëpunimi për bashkimin e operatorëve ekonomikë me nr. 412 prot, datë 24.01.2025 ku në nenin 3 “pjesëmarrja” përcaktohet se: *“Pala e parë shoqëria “Eral Construction Company” SHPK merr përsipër të kryejë 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së përgjithshme së punimeve të tenderuara. Pala e dytë shoqëria “K.M.K” shpk merr përsipër të kryejë 25 (njëzet e pesë) % të vlerës së përgjithshme të tenderuara, pala e tretë shoqëria “Caushi-M” shpk merr përsipër të kryejë 25 (njëzet e pesë) % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara....”*. Po ashtu, shoqëritë në këtë marrëveshje në pikën 5.1 kanë përcaktuar se: *“Elementët që merr përsipër të realizojë secili anëtar i BOE janë të përcaktuara sipas ndarjes së punimeve, bashkëngjitur kësaj marrëveshje bashkëpunimi.*
- Licencë LN-4498-07-2022, lëshuar nga QKB në emër të K.M.K shpk, me kodin III.2.B, data e lëshimit 26.07.2022 dhe emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim dhe transporti i dherave ose shtufe. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”.
- Licencë LN-7599-06-2019, lëshuar nga QKB në emër të Eral Construction Company shpk, kodin III.2.B, data e lëshimit 25.06.2019, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim, transportim i mbetjeve inerte, dhera dhe shtuf. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”. Bashkëlidhur akti i miratimit, licencë e kategorisë III.2.B, me nr. 5981 prot., datë 25.06.2019

Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi*

duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve në ofertën e paraqitur, ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve, që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi, ku nga verifikimi i dokumentit të dorëzuar në SPE ndarja e punimeve sipas zërave të preventivit rezulton se secili nga operatorët do të përfshihet në realizimin e të gjithë punimeve të preventivit sipas përqindjes që kanë marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit. Referuar zërave të preventivit ndër të tjera operatorët ekonomikë do të kryejnë edhe transport materiale ndertimi, dheu etj. Në këto kushte Komisioni thekson, se kemi të bëjmë me një procedurë specifike e cila kërkon licencimin e shërbimit referuar kuadrit ligjor në fuqi. Në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh edhe pse punimet e zërave janë të ndarë në përqindje të caktuar, është përcaktuar ndarja e punimeve e të gjithë zërave të preventivit në masën 50 % “Eral Construction Company” SHPK, 25% “K.M.K” SHPK dhe 25 % “Caushi M” SHPK, Komisioni gjykon se për realizimin e punimeve sipas preventivit, nisur nga specifika e procedurës së prokurimit dhe në kushtet kur të tre anëtarët e bashkimit të operatorëve do të angazhohen në realizimin e punimeve, si dhe realizimin e transportit, cdo njëri prej tyre duhet të jetë i pajisur me licencën sipas kriterit të veçantë të kualifikimit të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK ankimues nuk qëndron.

III.7 Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK: “III. Nuk ploteson piken 2.3.11 d) për materialet elektrike mungon autorizimi për materialet elektrike nga Teoren për BOE .

Eshte ngarkuar ne SPE nje autorizim prodhuesi nga shoqeria Noark shpk per Teoren shpk per materialet elektrike, por mungon autorizimi nga Teoren per BOE. Sipas pikes 2.3.11, Operatoret Ekonomike duhet te paraqesin Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues- distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe. Mungesa e autorizimit të distributorit (Teoren shpk) për BOE është arsye për skualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.11 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.11 *Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:*

- a) *Tube Ujësjiellësi*
- b) *Hekur*
- c) *Rakorderi Ujësjiellësi*
- d) *Materiale elektrike,*

duhet të paraqesin:

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*
- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. **Shënim:** Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.*
- *Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë certifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.*
- *Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane të pajisura me certifikatë ose deklaratë konformiteti CE.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: *Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të*

miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

III.7.2 Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit pikës 2.3.11 BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar dokumentacionin si vijon:

- Dokumentin Autorizim prodhuesi lëshuar në datë 19.01.2024 nga shoqëria NOARK Electric Europe s.r.o me përmbajtje si vijon: *“...Shoqeria NOARK Electric Europe s.r.o., ne cilesine e prodhuesit te produkteve elektrike autorizon: Teoren Sh.p.k., Borake, Km 15. Durres-Tirane, Durres-R. Albania, VAT: K51407506E si distributor zyrtar, te shoqerise Noark Electric ne Shqiperi. Nepermjet ketij autorizimi, I japim te drejte shoqerise Teoren Shpk, te mare pjese me produkte dhe dokumentat tona ne prokurimet publike qe do te zhvillohen ne Shqiperi.”.*
- Cetifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të cilësisë me nr. të certifikatës AQS/Q/84592022, emri i kompanisë Teoren shpk, standardi EN-ISO 9001:2015 për fushat e aktiviteteve si më poshtë: *“Import eksport tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm elektrikë, hidraulikë, sanitare, ndriçues, ndërtimi, produkte industriale, elektroshtëpiake, kondicionim, pompa, termofasada, bojra, filtra uji, Projektim, zbatim, vendosje, dhe mirëmbajtje e sistemeve elektrike. Hidraulike, sanitare, ndriçues, sisteme filtrimi uji, sistem osmoze, sistem kondicionimi, të termofasadave, sistem ventilimi”.*
- Cetifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të mjedisit me nr. të certifikatës AQS/Q/84602022, emri i kompanisë Teoren shpk, standardi EN-ISO 14001:2015 për fushat e aktiviteteve si më poshtë: *“Import eksport tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm elektrikë, hidraulikë, sanitare, ndriçues, ndërtimi, produkte industriale, elektroshtëpiake, kondicionim, pompa, termofasada, bojra, filtra uji, Projektim, zbatim, vendosje, dhe mirëmbajtje e sistemeve elektrike. Hidraulike, sanitare, ndriçues, sisteme filtrimi uji, sistem osmoze, sistem kondicionimi, të termofasadave, sistem ventilimi”, si dhe deklarata të konformitetit të BE-së për materialet elektrike.*

III.7.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.7.4. Në nenin 44 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

III.7.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.7.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që: **“2.3.11 Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:**

a) *Tube Ujësjellësi*

- b) Hekur
- c) Rakorderi Ujësjiellësi
- d) Materiale elektrike,

duhet të paraqesin: Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.....“, Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE Komisioni konstaton se, BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar në SPE Dokumentin Autorizim prodhuesi lëshuar në datë 19.01.2024 nga shoqëria NOARK Electric Europe s.r.o me përmbajtje si vijon: “...Shoqeria NOARK Electric Europe s.r.o., ne cilesine e prodhuesit te produkteve elektrike autorizon: Teoren Sh.p.k., Borake, Km 15. Durres-Tirane, Durres-R. Albania,VAT: K51407506E si distributor zyrtar, te shoqerise Noark Electric ne Shqiperi. Nepermjet ketij autorizimi, i japim te drejte shoqerise Teoren Shpk, te mare pjese me produkte dhe dokumentat tona ne prokurimet publike qe do te zhvillohen ne Shqiperi”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar Komisioni konstaton se BOE “Eral Construction Company” SHPK & “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK nuk ka dorëzuar autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit. Në këto kushte BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK nuk përmbush pikën 2.3.11 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK nuk qëndron.

III.8 Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të BOE “EC Pro Partners” SHPK dhe “Gjiguria” SHPK, gjykojmë, se referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK, nuk do të ndryshojë duke mbetur i skualifikuar nga procedura në fjalë, rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III. 9. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “LTE Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK: “Ne VKM nr.285 date 19.05.2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit Publik citohet shprehimisht: Neni 90 Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera a)Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

b) Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; Në përputhje me kërkesat e tenderit dhe specifikimet e tij, operatorët mbështetës duhet të deklarojnë qartë se për cilin operator ekonomik (OE) ata janë mbështetës. Varaku shpk dhe Trust shpk në formularët përmbledhës të vetëdeklarimit të shtojcës nr. 08 nuk kanë deklaruar se për cilin operator janë mbështetës. Ata e deklarojnë se mbështetës OE L.T.E Konstruksion sh.p.k vetëm në deklaratat e tyre respektive te angazhimit.

Ne zbatim te Ligjit të Prokurimeve Publike neni 84 pika b, VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit Publik” neni 90, pika a dhe kushteve të DST-se te percaktuara nga APP me Vendimin nr.10, date 23.09.2024 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “e hapur”, e konsiderojme shtojcen 8 te operatoreve mbeshtetes Varaku shpk dhe Trust shpk te paplotesuar ne formen e kerkuar ne DST. Per sa me siper mangesite e konstatuara nga komisioni vleresimit te ofertave i gjykojme arsye per skualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.9.1. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
--------------	------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik			
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

		mbështetet operatori ekonomik	

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta

për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

¹Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin

ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 1. . _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____, 2. . _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____, 3. . _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____,

	Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	---

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME

PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vijë në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/pro dukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve. Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, etj ., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti. Emri, Mbiemri _____ Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër

- *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*
- *Në procedurat e prokurimit me fazë, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.*
- *Ofertuesi i kualifikuar i pari, si dhe kandidatet e kualifikuar në fazën e parë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojnë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar.*
- *Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.9.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) Komisioni konstatoi se në funksion të plotësimit të kriterit të mësipërm BOE “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK ka dorëzuar:

- Formular Përmbledhës të vetëdeklarimit të shoqërisë “L.T.E Construction” SHPK
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të shoqërisë “Ndregjoni” Shpk;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “ZEQILLARI” shpk + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Zeqillari” shpk;
- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik Varaku E SHPK + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Varaku E” SHPK;
- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Trust Construction” shpk + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Trust Construction” SHPK;
- Kontratë për bashkëpunimin e përkohëshëm të shoqërive Tregtare J.V me nr. 170 prot., datë 27.01.2025 lidhur ndërmjet shoqërisë L.T.E Construction shpk dhe shoqërisë Ndregjoni Shpk ku në pikën 3.2 të nenit 3 parashikohet si vijon: *“Pjesëmarrja e palëve e shprehur në përqindje si për investimin në arritjen e objektit të kësaj kontrate dhe ndarjen e fitimit të jetë konkretisht:*
a) *L.T.E Construction shpk do të ketë një pjesëmarrje 41.8 %, b) “Ndregjoni” SHPK do të ketë një pjesëmarrje 58.82 %*

Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit numër 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto 57 kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve,*

shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues”.

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të vkm nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “1. *Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

2. *Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:*

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.9.3. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.9.4 Nisur nga arsyetja e skualifikimit të BOE “L.T.E Construction” shpk dhe “Ndregjoni” shpk, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga anëtarë i BOE “L.T.E Construction” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formular përmbledhës vetëdeklarimi të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesën I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektin dhe mbi kapacitetin, e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK. Konkretisht, mbështetet tek operatori ekonomik “Trust Construction” SHPK; konkretisht për pikën 2.3.5 staf teknik, tek operatori ekonomik “Varaku E” SHPK, konkretisht për pikën 2.3.3 me fuqi punëtore në listëpagesë, si dhe për pikën (i) me mjete

1. Trencher për hapje kanali me fletë doganore R46227 13.06.2020, 2. Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 13.07 ton targa DR****, Leja DR0030848, shasia WD****, tek operatori ekonomik “Zeqillari” SHPK, në pikën 2.3.4 staf inxhinierik.....” .

Nga shqyrtimi, i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik ankimes, konstatohet se ky i fundit, për operatorin ekonomik “Varaku E” SHPK, për operatorin “Trust Construction” SHPK, për operatorin “ Zeqillari” SHPK, si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet, ka paraqitur Formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Varaku E” SHPK të firmosur dhe vulosur, formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Trust Construction” SHPK të firmosur dhe vulosur, formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Zeqillari” SHPK të firmosur dhe vulosur. Gjithashtu ka dorëzuar deklaratë të administratorit të shoqërisë “Varaku E” SHPK si subjekt mbështetës për shoqërinë “L.T.E Construction” SHPK, ku pala mbështetëse deklaron se do të mbështesë shoqërinë “L.T.E Construction” SHPK për pikën 2.3.3 me fuqi punëtore në listëpagesa për periudhën tetor, nëntor, dhjetor 2024 me 20 punonjës dhe me mjete 1. Trencher për hapje kanali me fletë doganore R46227 13.06.2020, 2. Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 13.7 ton, targa DR****, Leja DR 0030848, shasia WD**, gjithashtu ka dorëzuar deklaratë të administratorit të shoqërisë “Trust Cosntruction” SHPK ku pala mbështetëse deklaron se do të mbështesë shoqërinë “LTE Construction” SHPK për pikën 2.3.5 staf teknik, gjithashtu ka dorëzuar deklaratë të administratorit të shoqërisë “Zeqillari” shpk ku pala mbështetëse ka deklaruar se do të mbështesë operatorin ekonomik “LTE Construction” SHPK në pikën 2.3.4 b) të DST.

Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në

kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së; - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se, për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se, **“Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”**.

III.9.5. Në rastin konkret nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “LTE Construction” SHPK konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur ka paraqitur Formular përmbledhës vetëdeklarimi të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektin dhe mbi kapacitetin, e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK. Konkretisht, mbështetet tek operatori ekonomik “Trust Construction” SHPK; konkretisht për pikën 2.3.5 staf teknik, tek operatori ekonomik “Varaku E” SHPK, konkretisht për pikën 2.3.3 me fuqi punëtore në listëpagesë, si dhe për pikën (i) me mjete 1.Trencher për hapje kanali me fletë doganore R46227 13.06.2020, 2. Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 13.07 ton targa DR***, Leja DR0030848, shasia WDB***, tek operatori ekonomik “Zeqillari” SHPK, në pikën 2.3.4 staf inxhinierik.....” .

Nga shqyrtimi, i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit, për operatorin ekonomik “Varaku E” SHPK, për operatorin “Trust Construction” SHPK, për operatorin “Zeqillari” SHPK, si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet, ka paraqitur Formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Varaku E” SHPK të firmosur dhe vulosur, formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Trust Construction” SHPK të firmosur dhe vulosur, formular përmbledhës vetëdeklarimi të operatorit ekonomik “Zeqillari” SHPK të firmosur dhe vulosur. Gjithashtu ka dorëzuar deklaratë të administratorit të shoqërisë, si dhe deklaratë nga administratori i shoqërisë në kapacitetet e të cilit do të mbështetet. Referuar bazës ligjore të sipërcituara kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës, si dhe referuar dokumentave të tenderit konkretisht shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës vetëdeklarimi”, Pjesa I. B: Deklaratë “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilave do të mbështetet operatori ekonomik”, është subjekti i cili do të mbështetet, i cila duhet të deklarojë subjektet mbështetëse. Një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe

nga subjekti mbështetës. Pra operatori ekonomik mbështetës ka detyrimin që të dorëzojë formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të plotësuar në të gjitha fushat, por nuk ka detyrimin që të deklarojë në formular se cilin subjekt mbështet pasai vetë formulari nuk e përmban një fushë të tillë.

Sa më sipër arsyetuar pretendimi i KVO-së bie në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Pretendimi i BOE “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK qëndron.

III.10 Lidhur me skualifikimin e BOE “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK me arsyetimin se: “...II-Nuk ploteson piken 2.3.5 të DST-se lidhje me punonjesit staf mbështetës Ne baze të kontratës së bashkepunimit neni 3 pika 3.4 ku citohet se Shoqeria LTE do marrë persipër të gjithë zerrat e preventivit I.A Ndertimi i Ujësjellësit të Fshatit Fushëbardhë dhe pajisje makineri Zerin 1 . An.Cmim Tregu Transformator fuqie, 100 KVA,20/10/0.4KV cop 3 , të cilat perbejne ne vlere totale të preventivit 107,998,543.37 Lek me TVSH dhe 41.18% të totalit, duke marr parasysh këte pike OE L.T.E Konstruksion nuk ka deklaruar 1 murator, 1 hidroizolues për zerrat të cilat duhet të realizohen sipas preventivit që kanë marr persipër secila shoqeri.

-Ne baze të kontratës së bashkepunimit neni 3 pika 3.4 ku citohet se Shoqeria Ndregjoni do marrë persipër të gjithë zerrat e preventivit I.B Ndertimi i Ujësjellësit të Fshatit Zhulat dhe pajisje makineri Zerin 2 An.Cmim Tregu Sistemi i klorinimit me dy el/pompa klori $Q=0.025-7$ L/ore PN = 16 bar + rezervuar klori 1000 litra + nyjen injektuese + tubat transparent të lidhjes cop 4 ,të cilat perbejne ne vlere totale të preventivit 154,234,460.95 LEK me tvsh dhe 58.82% të totalit, OE Ndregjoni shpk nuk ka deklaruar 1 Suvatues për zerrat të cilat duhet të realizohen sipas preventivit që kanë marr persipër secila shoqeri.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.10.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.5 Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|-----------|
| • Teknik Ndërtimi | 2 (dy) |
| • Teknik Topograf | 1 (një) |
| • Karpentier | 3 (tre) |
| • Murator | 2 (dy) |
| • Saldator | 2 (dy) |
| • Hekurkthyes | 2 (dy) |
| • Specialist Ndërtimi | 2 (dy) |
| • Suvatues | 2 (dy) |
| • Hidraulike | 4 (kater) |
| • Hidroizolues | 2 (dy) |

- *Elektricitist* 2 (dy)
- *Punonjës të konstruksioneve metalike* 2 (dy)
- *Shoferë* 4 (katër)
- *Punëtori e thjeshtë* 20 (njetete)
- *Manovrator* 3 (tre)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)	Nr.Diplome /Nr.Amze
1					
2					
Etj.					

- *Kontratat e punës individuale (të vlefshme).*
- *Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH.”, i ndryshuar.*
- *Të gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë, minimalisht për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.*
- *Për Teknikun e Ndërtimit, Teknikun Topograf, duhet të paraqitet dëftesë e shkollës së mesme.*

Për Manovrator/automakinistë/shoferë/buldozeristë, të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR. Në rastin kur punonjësit e mësipërm janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht për mjetet e marra me qira nga persona fizikë, nuk kërkohet të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë.

Dokumentacioni (Diplomat/dëshmitë/certifikatat) që nuk janë lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimimit profesional, do të konsiderohen jo të sakta dhe bëhen shkak për veprime të mëtejshmesipas parashikimeve përkatëse të ligjit tëprokurimitpublik.

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.*

III.10.2. Në shtojcën 7, tek “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 7.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;*
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;*
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;*
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.*

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*
- *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

III.10.3 Ndërsa, në shtojcën 7, tek “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/b, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

III.10.4. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 8

Shtojca 8.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

**I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga

data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër².

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

²Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: 4. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____, 5. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____,

	6. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë _____ sonë, në rolin e _____, Makineri e mjete Po [] Jo [] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	---

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vë në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					

3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/pro dukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruar në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë
sonë, në rolin e _____,
etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, si dhe kandidatet e kualifikuar në fazën e parë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e

ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojnë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara.

- **Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**
- **Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.**

III.10.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” ShPK, në përmbushje të kritereve sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formular Përmbledhës të vetëdeklarimit të shoqërisë “L.T.E Construction” SHPK;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të shoqërisë “Ndregjoni” Shpk;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “ZEQILLARI” shpk + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Zeqillari” shpk;
- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik Varaku E SHPK + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Varaku E” SHPK;
- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Trust Construction” shpk + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Trust Construction” SHPK;
- Kontratë për bashkëpunimin e përkohëshëm të shoqërive Tregtare J.V me nr. 170 prot., datë 27.01.2025 lidhur ndërmjet shoqërisë L.T.E Construction shpk dhe shoqërisë Ndregjoni Shpk ku në pikën 3.2 të nenit 3 parashikohet si vijon: “Pjesëmarrja e palëve e shprehur në përqindje si për investimin në arritjen e objektit të kësaj kontrate dhe ndarjen e fitimit të jetë konkretisht:
a) L.T.E Construction shpk do të ketë një pjesëmarrje 41.8 %, b) “Ndregjoni” SHPK do të ketë një pjesëmarrje 58.82 %.

III.10.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.10.6. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.10.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.10.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga*

autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi; l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti

kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime..”

III.10.9. Në nenin 88, pika 1, 2 dhe 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

III.10.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ka për detyrë të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.10.11. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të BOE “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK, si dhe referuar dokumentave të tenderit, Komisioni thekson se, ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formular Përmbledhës të vetëdeklarimit të shoqërisë “L.T.E Construction” SHPK;
 - Formular përmbledhës vetëdeklarimi të shoqërisë “Ndregjoni” Shpk;
 - Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “ZEQILLARI” shpk + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Zeqillari” shpk;
 - Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Varaku E” SHPK + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Varaku E” SHPK;
 - Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Trust Construction” shpk + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Trust Construction” SHPK;
 - Kontratë për bashkëpunimin e përkohëshëm të shoqërive Tregtare J.V me nr. 170 prot., datë 27.01.2025 lidhur ndërmjet shoqërisë “L.T.E Construction” shpk dhe shoqërisë “Ndregjoni” Shpk ku në pikën 3.2 të nenit 3 parashikohet si vijon: “Pjesëmarrja e palëve e shprehur në përqindje si për investimin në arritjen e objektit të kësaj kontrate dhe ndarjen e fitimit të jetë konkretisht:
- a) L.T.E Construction shpk do të ketë një pjesëmarrje 41.8 %, b) “Ndregjoni” SHPK do të ketë një pjesëmarrje 58.82 %.

Neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve në ofertën e paraqitur, ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve, që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë, “L.T.E Construction” SHPK, ka marrë përsipër të kryejë në masën 41.18 % zërat e preventivit, duke marrë përsipër të gjithë zërat e preventivit I.A Ndërtimi i Ujësjiellësit të Fshatit Fushë Bardhë dhe pajisje makineri zërin 1. An. Cmim Tregu transformator fuqie 100 KVA, 20/10.04KV cop 3, ndërsa operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK ka marrë përsipër të gjithë zërat e preventivit I.B Ndërtimi i Ujësjiellësit të Fshatit Zhulat dhe pajisje makineri zërin 2 An.Cmim Tregu sistemi i klorinimit me dy pompa el/pompa klori Q=0.025-7 L/ore PN=16 bar+rezervuar klori 1000 litra + nyjën injektuese+tubat transparent të lidhjes, të cilat përbëjnë 58.82 % të totalit. Referuar kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik, KPP konstaton se numri i punonjësve të kërkuar për këto specialitete staf teknik në total është 53 punonjës. Në kushtet kur operatori ekonomik pjesëmarrës është një bashkim operatorësh dhe punimet e zërave janë të ndarë në përqindje të caktuara, Komisioni konstaton se anëtarët e bashkimit të operatorëve “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK përmbushin nr. e stafit teknik sipas përqindjes që kanë marrë përsipër. Nga ana tjetër përse i përket arsyes së skualifikimit se “OE L.T.E Konstruktion nuk ka deklaruar 1 murator, 1 hidroizolues për zërat të cilat duhet të realizohen sipas preventivit që kanë marrë përsipër secila shoqëri.

-Ne baze te kontrates se bashkepunimit neni 3 pika 3.4 ku citohet se Shoqeria Ndregjoni do marre persiper te gjithe zerat e preventivit I.B Ndertimi i Ujësjiellësit të Fshatit Zhulat dhe pajisje makineri Zer in 2 An.Cmim Tregu Sistemi i klorinimit me dy el/pompa klori $Q=0.025-7$ L/ore PN = 16 bar + rezervuar klori 1000 litra + nyjen injektuese + tubat transparent te lidhjes cop 4 ,te cilat perbejne ne vlere totale te preventivit 154,234,460.95 LEK me tvsh dhe 58.82% te totalit, OE Ndregjoni shpk nuk ka deklaruar 1 Suvatues per zerat te cilat duhet te realizohen sipas preventivit qe kane marr persiper secila shoqeri”, Komisioni thekson se në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Pjesa I, Deklaratë B: Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK ka deklaruar se do të mbështetet me staf teknik për pikën 2.3.5 në kapacitetet e operatorit ekonomik “Trust Construction” SHPK për punonjësin Z. E. Q me profesion specialist ndërtimi. Gjithashtu në Kontratën me nr. 170 prot., datë 27.01.2025 kontratë për bashkëpunimin e përkohëshëm të shoqërive tregtare JV të lidhur ndërmjet shoqërisë L.T.E Construction shpk dhe “Ndregjoni” SHPK në nenin 3 pjesëmarrja pika 3.1 parashikohet se: “Palët synojnë të marrin pjesë si një subjekt i vetëm, të bashkëpunojnë me mjetet dhe stafet përkatëse për realizimin e këtij objekti dhe të marrin përsipër të pëtgjigjen ndaj çdo detyrimi që vjen si pasojë e ekzekutimit të kontratave që do të lidhen në rast përzgjedhjeje.” Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 88 të VKM ku parashikohet se: “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, në kushtet kur anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë plotësojnë në numër punonjësit e deklaruar sipas përqindjes që ka në pjesëmarrjen secili prej tyre, si dhe në kushtet kur kanë deklaruar se do të bashkëpunojnë me stafet dhe mjetet përkatëse argumentimi i KVO-së bie ndesh me parashikimin ligjor të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa më lart, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “L.T.E Cosntruction” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK qëndron.

III.11 Lidhur me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik “L.T.E Cosntruction” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK me arsyetimin se: *“III-Nuk ploteson piken 2.3.6 i te DST-se ne lidhje me disponueshmerine e mjeteve*

-Ne baze te kontrates se bashkepunimit neni 3 pika 3.4 ku citohet se Shoqeria LTE do marre persiper te gjithe zerat e preventivit I.A Ndertimi i Ujësjiellësit të Fshatit Fushëbardhë dhe pajisje makineri Zer in 1 . An.Cmim Tregu Transformator fuqie, 100 KVA,20/10/0.4KV cop 3 , te cilat perbejne ne vlere totale te preventivit 107,998,543.37 Lek me TVSH dhe 41.18% te totalit, duke marr parasysh kete pike shoqeria LTE nuk ka deklaruar Betoforma ne baze te perqindjes se punimeve duhet te deklaronte 82 cope, Depozite uji ne baze te perqindjes duhet te deklaronte 1 cope , per zerat te cilat duhet te realizohen sipas preventivit qe kane marr persiper secila shoqeri.
-Ne baze te kontrates se bashkepunimit neni 3 pika 3.4 ku citohet se Shoqeria Ndregjoni do marre persiper te gjithe zerat e preventivit I.B Ndertimi i Ujësjiellësit të Fshatit Zhulat dhe pajisje makineri

Zerin 2 An.Cmim Tregu Sistemi i klorinimit me dy el/pompa klori $Q=0.025-7$ L/ore PN = 16 bar + rezervuar klori 1000 litra + nyjen injektuese + tubat transparent te lidhjes cop 4 ,te cilat perbejne ne vlere totale te preventivit 154,234,460.95 LEK me tvsh dhe 58.82% te totalit, shoqeriaNdregjoni nuk ka deklaruar Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton duhet te deklaronte 2 cope ka deklaruar vetem 1 , Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton nuk ka deklaruar asnje duhet te deklaronte 1 cope,Autobetoniere duhet te deklaronte 1 cope ska deklaruar asnje, Autopompe betoni duhet te deklaronte 1 cope nuk ka deklaruar asnje, per zerat te cilat duhet te realizohen sipas preventivit qe kane marr persiper secila shoqeri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.11.1.Në dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 (i) ndër të tjera ka përcaktuar se:

i. Operatoret Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasi a
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	në pronësi ose me qira	copë	3
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	në pronësi ose me qira	copë	2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës nga 1 deri në 3 ton	në pronësi ose me qira	copë	2
4	Makineri Prerëse/Asfalti	në pronësi ose me qira	copë	1
5	Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1
6	Minieskavator	në pronësi ose me qira	copë	2
7	Fadromë me goma (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1
8	Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	copë	1
9	Trencher per hapje kanali	në pronësi ose me qira	copë	1
10	Grejder (mjet teknologjik me goma)	në pronësi ose me qira	copë	1
11	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	copë	1

12	Autobot Uji	në pronësi ose me qira	cope	1
13	Autobetonjerë	në pronësi ose me qira	copë	2
14	Rul vibrues Gomë-Hekur me kapacitet mbi 12 ton	në pronësi ose me qira	copë	1
15	Autopompë Betoni	në pronësi ose me qira	copë	2
16	Vibrator Betoni	në pronësi ose me qira	copë	2
17	Betoniere te vogla	në pronësi ose me qira	copë	2
18	GPS	në pronësi ose me qira	copë	1
19	Kontener Stacioner (zyra, ndërresa)	në pronësi ose me qira	copë	1
20	Sondë për shpim Pusesh	në pronësi ose me qira	copë	1
21	Betoforma	në pronësi ose me qira	m ²	200
22	Kokore	në pronësi ose me qira	copë	50
23	Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion”	në pronësi ose me qira	copë	1
24	Jelekë fosforeshentë	në pronësi ose me qira	copë	50
25	Matrapik	në pronësi ose me qira	copë	1
26	Aparat për kthim hekuri, Tranxhë hekuri	në pronësi ose me qira	copë	2
27	Gjenerator	në pronësi ose me qira	copë	1
28	Depozita uji minimumi 5000 litra	në pronësi ose me qira	copë	2
29	Aparaturë për test presioni tubash	në pronësi ose me qira	copë	1

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës të DST-ve, duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- **Për mjetet që shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qartë për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Për mjete të marra me qira/kontratë bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë/ bashkëpunimit.
- **Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë**, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira/Kontratë bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/ Kontratë Bashkëpunimi.
- Për autobitumatriçen të paraqitet certifikatë për transport lëndësh të rrezikshme.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet me anë të paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatorët ekonomikë, sipas shtojcës përkatëse në DST, dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

III.11.2.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” ShPK, në përmbushje të kritereve sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formular Përmbledhës të vetëdeklarimit të shoqërisë “L.T.E Construction” SHPK;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi të shoqërisë “Ndregjoni” Shpk;
- Formular përmbledhës vetëdeklarimi i operatorit ekonomik “ZEQILLARI” shpk + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Zeqillari” shpk;
- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik Varaku E SHPK + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Varaku E” SHPK;
- Formular Përmbledhës i vetëdeklarimit i operatorit ekonomik “Trust Construction” shpk + Deklaratë e administratorit të shoqërisë “Trust Construction” SHPK;
- Kontratë për bashkëpunimin e përkohëshëm të shoqërive Tregtare J.V me nr. 170 prot., datë 27.01.2025 lidhur ndërmjet shoqërisë L.T.E Construction shpk dhe shoqërisë Ndregjoni Shpk ku në pikën 3.2 të nenit 3 parashikohet si vijon: “Pjesëmarrja e palëve e shprehur në përqindje si për investimin në arritjen e objektit të kësaj kontrate dhe ndarjen e fitimit të jetë konkretisht:

a)L.T.E Construction shpk do të ketë një pjesëmarrje 41.8 %, b)”Ndregjoni” SHPK do të ketë një pjesëmarrje 58.82 %.

III.11.3 Neni 88, pika 3 i Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare,

profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve në ofertën e paraqitur, ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë, “L.T.E Construction” SHPK, ka marrë përsipër të kryejë në masën 41.18 % zërat e preventivit I.A Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit fushëbardhë dhe pajisje makineri zerin 1. An.Cmim tregu transformator fuqie 100 kva, 20/10/0.4KV cop 3, shoqëria “Ndregjoni” SHPK do të marrë përsipër të gjithë zërat e preventivit I.B ndërtimi i ujësjellësit të fshatit zhulat dhe pajisje makineri zërin 2 An.Cmim tregu sistemi klorinimit me dy el/pompa klori Q=0.025-7L/ore PN=16 bar+rezervuar klori 1000 litra + nyjen injektuese + tubat transparent të lidhjes cop 4, 58.82 %. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe nga verifikimi i dokumentave të ngarkuar në SPE, Komisioni konstaton se ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar mjetin betoforma 200 cope, Depozita uji minimumi 5000 litra 2(dy) , Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton 3(tre), Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton 2(dy), Autobetonjerë 2(dy), Autopompë Betoni 2(dy). Lidhur me mjetet e sipërcituara Komisioni konstaton se, operatori ekonomik “Ndregjoni” SHPK në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në Pjesën III, C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” ka deklaruar betoforma 200 m2, depozitë uji minimumi 500 litra 2 copë, kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton 1 copë, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton (0), autobetoniere (0), autopompë betoni, ndërsa operatori ekonomik “L.T.E Construction” shpk në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në Pjesën III, C: Deklaratë “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” ka deklaruar betoforma (0), depozita uji minimumi 5000 litra nuk ka deklaruar, kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton ka deklaruar 2 (dy) copë, Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton ka deklaruar 1(një), Autobetonjerë 2(dy), autopompë betoni 2 (dy) copë. Gjithashtu në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit operatori ekonomik “L.T.E Construction” SHPK në pjesën I, B:Deklaratë Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik ka deklaruar ndër të tjera se: “do të mbështetet në kapacitetet e operatorit ekonomik “Varaku E” shpk për mjetet 1. Trencher për hapje kanali, me fletë doganore R46227 13.06.2020 dhe kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës 13.7 ton targa DR***, Leja DR0030848, shasi WDB***. Referuar deklarimeve të bëra nga anëtarët e BOE “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK, Komisioni thekson se me të vërtetë anëtari i BOE “L.T.E Construction” SHPK ka deklaruar mjetet e sipërpërmendura duke mbuluar në këtë mënyrë dhe operatorin ekonomik “ndregjoni” SHPK, dhe nga ana tjetër dhe “Ndregjoni” SHPK me mjetet e deklaruara në total mbulon dhe operatorin ekonomik “L.T.E Construction” SHPK, por gjithashtu BOE ka marrë përsipër një përqindje të caktuar të punimeve të cilat do të realizojë secili prej tyre dhe rrjedhimisht me deklaratimet e bëra duhet ti përmbahen edhe përqindjes së caktuar në marrëveshje në përputhje me rregullat e prokurimit publik ku përcaktohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së,

dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

Sa më sipër pretendimi i BOE “L.T.E Construction SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK nuk qëndron.

III.12. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK: “.....• *Në dokumentacionin e ofruar nga operatorët ekonomikë LTE Konstruksion dhe Ndregjoni shpk, katalogët për listën e artikujve të cituar nga AK janë të papërkthyer. Kjo është një shkelje e kërkesës së tenderit për ofrimin e informacionit të qartë dhe të kuptueshëm për të gjitha palët. Sipas kushteve të tenderit, është e kërkuar që dokumentet dhe katalogët që përmbajnë informacion për artikujt dhe materialet e përdorura në projekt të jenë të përkthyer dhe të kuptueshëm për komisionin vlerësues të ofertave. Mungesa e përkthimit të këtyre katalogëve na ka shkaktuar vështirësi në vlerësimin e ofertës gjatë procesit të vlerësimit të procedurës. Kataloget e paraqitur nuk janë në përputhje me kërkesat e DST-se*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.12.1. Në dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.11 ndër të tjera ka përcaktuar se:

2.3.11 *Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:*

- e) *Tabo Ujësjiellësi*
- f) *Hekur*
- g) *Rakorderi Ujësjiellësi*
- h) *Materiale elektrike,*

duhet të paraqesin:

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbësite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*
- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet*

e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

- *Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë certifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.*
- *Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane të pajisura me certifikatë ose deklaratë konformiteti CE.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: *Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.*

III.12.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” ShPK, në përmbushje të kritereve sa më sipër, ka dorëzuar:

- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_a_Hekur_Diler_Katalog_ISO, (Katalog Diler Holding DILER DEMİR ÇELİK DILER IRON & STEEL);
- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_b_Tubo_Uji_Katalog_Iso, (katalog akansu pipe) ;
- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_c_Rakorderi_Katagot_Iso, (katalog +GF+);
- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_d_Matësar_Certifikatat_dhe_Katalogët, (Katalog lëshuar nga Romanian Movement for Quality);
- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_elektrike_LDT_ISO_Katalog, (Katalog LDT 2020 Electrical materials production);
- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_Elektrike_Elettrocanali_Iso_Katalog (EC elettrocanali THE ITALIAN EVOLUTION OF ELECTRICITY);
- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_Elektrike_Geëiss_ISO_Katalog (katalog lëshuar nga Geëiss);
- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_Elektrike_IRCE_ISO_KATALOG, (Katalog lëshuar nga iRce);
- Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_Elektrike_Optonica_Iso_Katalog (katalog lëshuar nga Optonica LED, Catalog 2024).

III.12.3. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “4. *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet se: “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”

III.12.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

III.12.5. Nisur nga arsyet e skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” ShPK konkretisht, Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_a_Hekur_Diler_Katalog_ISO, (Katalog Diler Holding DİLER DEMİR ÇELİK DILER IRON & STEEL), Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_b_Tubo_Uji_Katalog_Iso, (katalog akansu pipe), Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_c_Rakorderi_Katatalog_Iso, (katalog +GF+), Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_d_Matësar_Certifikatat_dhe_Katalogët, (Katalog lëshuar nga Romanian Movement for Quality), Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_elektrike_LDT_ISO_Katalog, (Katalog LDT 2020 Electrical materials production), Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_Elektrike_Elettrocanali_Iso_Katalog (EC elettrocanali THE ITALIAN EVOLUTION OF ELECTRICITY), Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_Elektrike_Geëiss_ISO_Katalog (katalog lëshuar nga Geëiss), Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_Elektrike_IRCE_ISO_KATALOG, (Katalog lëshuar nga iRce), Dokumentin pdf të emërtuar 2_3_11_e_Elektrike_Optonica_Iso_Katalog (katalog lëshuar nga Optonica LED, Catalog 2024) konstatoi se katalogët e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik nuk janë të përkthyer në gjuhën shqip. Nisur nga pretendimi i BOE për kundërshtimin e skualifikimit me arsyetimin se: “....Pra në këtë pikë autoriteti nuk ka kërkuar që katalogët të jenë të përkthyer ashtu sikurse ka kërkuar për pikën tjetër në lidhje me autorizimet e prodhuesit të cilën e ka specifikuar se Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe. Pra ashtu sikurse ka përcaktuar për autorizimin e prodhuesit AK duhej të përcaktonte edhe për katalogët, pasi përse kohë që nuk është përcaktuar atëherë edhe ne kemi plotësuar aq sa AK ka kërkuar në kriter”, si dhe referuar

dokumentave të tenderit, Komisioni thekson se, procedura e prokurimit objekt ankimi është “Procedurë e hapur”. Referuar pikës 2 të neni 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: “2. *Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.*”, në këto kushte Komisioni gjykon se, duke qënë se procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë nën kufirin e lartë monetar ligjvënësi ka përcaktuar se gjuha e prokurimit e përdorur është gjuha shqip dhe rrjedhimisht dhe oferta e dorëzuar duhet ti përmbahet gjuhës së prokurimit. Akoma më tej siç përcaktohet në rregullat e prokurimit publik vetëm në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në rastin konkret kur gjuha e prokurimit është gjuha shqip operatori ekonomik ofertues duhet të përkthejë dhe noterizojë sipas legjislacionit në fuqi dokumentacionin shoqërues të ofertës. Në këto kushte sa më sipër arsyetuar, Komisioni gjykon se, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik nuk qëndron, pasi dokumentacioni i dorëzuar duhet të ishte përkthyer në gjuhën shqip në përputhje me parashikimet e rregullave të prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimi i BOE “L.T.E Construction” SHPK dhe “Ndregjoni” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e 11 Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Nderim i ujesjellesave të fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në

datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk në procedurën e prokurimit të mësipërme.
 3. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “L.T.E Construction” Sh.p.k & “Ndregjoni” Sh.p.k për procedurën e prokurimit të mësipërme.
 4. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
 5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruksion” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK, BOE “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk, si dhe BOE “L.T.E Construction” Sh.p.k & “Ndregjoni” Sh.p.k.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsyetimit të vendimit të rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga BOE “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk, konkretisht nuk jam dakord me arsyetimin në pikën III.6 e në vijim, III.7 e në vijim, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Rilindja Tiefbau” SHPK & “Viante Konstruktion” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Eral construction company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk në procedurën e prokurimit të mësipërme.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “EC Pro Partners” SHPK & “Gjikuria” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “L.T.E Construction” SHPK & “Ndregjoni” SHPK në procedurën mësipërme e prokurimit.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Eral Construction Company” SHPK & “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK: “II. 2.3.8 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me: Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), së bashku me aktin e miratimit.

OE K.M.K – Ky operator ekonomik ofertues pjese e BOE nuk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) akt-miratimin për licencën (LN-4498-07-2022, Date 26.07.2022) me Kod III.2.B, e kërkuar në pikën 2.3.8 të DST-së. Mungesa e Akt-Miratimit, përbën një shkelje të kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhojë, është arsye për skualifikimin e BOE-së.

OE CAUSHI M shpk – Ky operator ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE asnjë dokument që vërteton përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 2.3.8 të DST-së, lidhur me licencën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta inerte, pra nuk ka ngarkuar licencën Kodi III.2.B dhe akt-miratimin. Mungesa e këtij dokumenti përbën arsye për skualifikimin e BOE-së.”, vërej se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.8 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.8 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me:

- Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) **Kodi III. 2. B** “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), së bashku me aktin e miratimit.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si vijon:

- Marrëveshje bashkëpunimi për bashkimin e operatorëve ekonomikë me nr. 412 prot, datë 24.01.2025 ku në nenin 3 “pjesëmarrja” përcaktohet se: “Pala e parë shoqëria “Eral Construction Company” SHPK merr përsipër të kryejë 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së përgjithshme së punimeve të tenderuara. Pala e dytë shoqëria “K.M.K” shpk merr përsipër të kryejë 25 (njëzet e pesë) % të vlerës së përgjithshme të tenderuara, pala e tretë shoqëria

“Caushi-M” shpk merr përsipër të kryejë 25 (njëzet e pesë) % të vlerës së përgjithshme të punimeve të tenderuara....”

- Licencë LN-4498-07-2022, lëshuar nga QKB në emër të K.M.K shpk, me kodin III.2.B, data e lëshimit 26.07.2022 dhe emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim dhe transporti i dherave ose shtufe. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”.
- Licencë LN-7599-06-2019, lëshuar nga QKB në emër të Eral Construction Company shpk, kodin III.2.B, data e lëshimit 25.06.2019, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim, transportim i mbetjeve inerte, dhera dhe shtuf. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”. Bashkëlidhur akti i miratimi, licencë e kategorisë III.2.B, me nr. 5981 prot., datë 25.06.2019.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që*

do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.6. Në nenin 39 pika 6 germa a) “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose....”

III.1.7. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe

mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”. Ky ligj përcakton: a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë; b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka për detyrë të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK “, konstatohet, se bashkimi i operatorëve ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin: Licencë LN-4498-07-2022, lëshuar nga QKB në emër të “K.M.K” shpk, me kodi III.2.B, data e lëshimit 26.07.2022 dhe emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim dhe transporti i dherave ose shtufe. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”. Licencë LN-7599-06-2019, lëshuar nga QKB në emër të shoqërisë “Eral Construction Company” shpk, kodi III.2.B, data e lëshimit 25.06.2019, emërtimi përshkrues i veprimtarisë: grumbullim,

transportim i mbetjeve inerte, dhera dhe shtuf. Afati i vlefshmërisë: “Pa afat”. Bashkëlidhur akti i miratimi, licencë e kategorisë III.2.B, me nr. 5981 prot., datë 25.06.2019.

III.1.10 Referuar arsyetimit të autoritetit kontraktor rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK, është s’kualifikuar për mospërbushje të kërkesës, nga anëtari i bashkimi të operatorëve “KMK” sh.p.k dhe “Caushi M” shpk me arsyetimin se: *Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me: Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), sëbashku me aktin e miratimit.*

OE K.M.K – Ky operator ekonomik ofertues pjese e BOE nuk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) akt-miratimin për licencën (LN-4498-07-2022, Date 26.07.2022) me Kod III.2.B, e kërkuar në pikën 2.3.8 të DST-së. Mungesa e Akt-Miratimit, përbën një shkelje të kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhojë, është arsye për skualifikimin e BOE-së.

OE CAUSHI M shpk – Ky operator ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE asnjë dokument që vërteton përmbushjen e kushteve të përcaktuara në pikën 2.3.8 të DST-së, lidhur me licencën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta inerte, pra nuk ka ngarkuar licencën Kodi III.2.B dhe akt-miratimin. Mungesa e këtij dokumenti përbën arsye për skualifikimin e BOE-së. Referuar dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.8 ndër të tjera ka përcaktuar se: *“2.3.8 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur me: Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”, mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13. 02. 2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11. 05. 2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”), së bashku me aktin e miratimit.”*

Ligji për Prokurimin Publik (LPP) në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht neni 88, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryej secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga BOE “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k dhe “Caushi M” shpk, gjykoj se, ky bashkim operatorësh ka dhënë një indicie që e plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.8 të dokumentave të tenderit. Lidhur me mungesën e aktit të miratimit të licencës të operatorit ekonomik “K.M.K” SHPK arsyetoj se në momentin që ekziston një licencë e lëshuar nga QKB rrjedhimisht ka dhe një akt miratimi të licencës. Në këto

kushte autoriteti kontraktor të kërkonte sqarime nga operatori ekonomik “K.M.K” SHPK. Gjithashtu përse i përket arsyes se operatori ekonomik “Caushi M” SHPK nuk ka ngarkuar në SPE licencën, arsyetoj se referuar rregullave të prokurimit publik ku përcatohet se: “Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, KVO duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik “Caushi M” SHPK.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k dhe “Caushi M” shpk qëndron.

III.2 Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “Eral Construction Company” SHPK & “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK: *“III. Nuk ploteson piken 2.3.11 d) për materialet elektrike mungon autorizimi për materialet elektrike nga Teoren për BOE .*

Eshte ngarkuar ne SPE nje autorizim prodhuesi nga shoqeria Noark shpk per Teoren shpk per materialet elektrike, por mungon autorizimi nga Teoren per BOE. Sipas pikes 2.3.11, Operatoret Ekonomike duhet te paraqesin Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues- distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe. Mungesa e autorizimit te distributorit(Teoren shpk) per BOE eshte arsye per skualifikim”, vërej se,

III.2.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.11 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.11 *Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:*

- i) Turbo Ujësjiellësi*
- j) Hekur*
- k) Rakorderi Ujësjiellësi*
- l) Materiale elektrike,*

duhet të paraqesin:

- *Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota te prodhuesit si: Telefon, fax,*

e-mail,   b  site, e nevojshme p  r Autoritetin Kontraktor n   rast verifikimi nga ana e tij, si dhe t   jet   e vlefshme deri n   realizimin e plot   t   punimeve. N   rast t   disponimit t   autorizimit t   prodhuesit n   gjuh   t   huaj, ky dokument t   paraqitet i p  rkthyer dhe i noterizuar n   gjuh  n zyrtare shqipe.

- *Katalogun / et ose fragmente t   katalogut/eve e prodhuesit / ve p  r list  n e m  sip  rme t   artikujve n   t   cil  t t   tregohen dhe t   specifikohen qart   materialet q   do t   ofrohen. Sh  nim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet t   tregojn   leht  sisht dhe qart   q   jan   pjes   katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i p  rkasin.*
- *Operatori Ekonomik p  r t   gjitha materialet e m  siperme duhet t   paraqes   certifikat   / vet  deklarim nga Prodhuesi q   deklaron se sistemi i menaxhimit t   cil  sis   t   prodhuesit/ve   sht   sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon t   drejt  n p  r verifikimin e vet  deklarimit gjat   procesit t   vler  simit t   dokumentacionit.*
- *T   gjitha materialet e m  siperme duhet t   jen   sipas Standarteve Europiane t   pajisura me certifikat   ose deklarat   konformiteti CE.*

N   rast bashkimi t   operator  ve ekonomik  , secili operator ekonomik duhet t   dor  zoj   dokumentat e m  sip  rme sipas artikujve q   do t   marr   p  rsip  r t   furnizoj   referuar preventivit t   objektit t   prokurimit dhe kontrat  s s   bashk  punimit t   n  nshkruar.

Sh  nim: *T   gjitha normat dhe standartet e k  rkuara n   specifikimet teknike t   publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t   i referohen edhe ekuivalenteve t   tyre, standarteve shqiptare SSH t   miratuara nga Drejtoria e P  rgjithshme e Standartizimit DPS, n   ato raste kur k  to standarte jan   unifikuar nga kjo Drejtori.*

III.2.2 N   p  rmbushje t   kriterit t   ve  ant   t   kualifikimit pik  s 2.3.11 BOE “Eral Construction Company” SHPK & “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK n  r t   tjera ka dor  zuar dokumentacionin si vijon:

- Dokumentin Autorizim prodhuesi l  shuar n   dat   19.01.2024 nga shoq  ria NOARK Electric Europe s.r.o me p  rmbajtje si vijon: “...Shoqeria NOARK Electric Europe s.r.o., ne cilesine e prodhuesit te produkteve elektrike autorizon: Teoren Sh.p.k., Borake, Km 15. Durres-Tirane, Durres-R. Albania,VAT: K51407506E si distributor zyrtar, te shoqerise Noark Electric ne Shqiperi. Nepermjet ketij autorizimi, I japim te drejte shoqerise Teoren Shpk, te mare pjese me produkte dhe dokumentat tona ne prokurimet publike qe do te zhvillohen ne Shqiperi.”.
- Cetifikat   konformiteti p  r sistemin e menaxhimit t   cil  sis   me nr. t   certifikat  s AQS/Q/84592022, emri i kompanis   Teoren shpk, standardi EN-ISO 9001:2015 p  r fushat e aktiviteteve si m   posht  : “import eksport tregti me shumic   dhe pakic   t   artikujve t   ndrysh  m elektrik  , hidraulik  , sanitare, ndri  ues, nd  rtimi, produkte industriale,

elektroshtëpiake, kondicionim, pompa, termofasada, bojra, filtra uji, Projektim, zbatim, vendosje, dhe mirëmbajtje e sistemeve elektrike. Hidraulike, sanitare, ndriçues, sisteme filtrimi uji, sistem osmoze, sistem kondicionimi, të termofasadave, sistem ventilimi.

- Certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit të mjedisit me nr. të certifikatës AQS/Q/84602022, emri i kompanisë Teoren shpk, standardi EN-ISO 14001:2015 për fushat e aktiviteteve si më poshtë: “Import eksport tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm elektrikë, hidraulikë, sanitare, ndriçues, ndërtimi, produkte industriale, elektroshtëpiake, kondicionim, pompa, termofasada, bojra, filtra uji, Projektim, zbatim, vendosje, dhe mirëmbajtje e sistemeve elektrike. Hidraulike, sanitare, ndriçues, sisteme filtrimi uji, sistem osmoze, sistem kondicionimi, të termofasadave, sistem ventilimi.

III.2.3. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.4. Në nenin 44 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që: “**2.3.11 Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:**

- e) *Tube Ujësjetësi*
- f) *Hekur*
- g) *Rakorderi Ujësjetësi*
- h) *Materiale elektrike,*

duhet të paraqesin: Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbssite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe..... “,

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka skualifikuar BOE “Eral Construction Company” shpk & “KMK” shpk & “Caushi M” shpk mbi bazën e mospërmbushjes së pikës 2.3.11, shkronja “d”, të dokumenteve standarde të tenderit, lidhur me mospasjen e një autorizimi të drejtpërdrejtë nga distributori “Teoren” shpk për BOE-në, për materialet elektrike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se BOE ka paraqitur autorizimin e lëshuar nga prodhuesi NOARK Electric Europe s.r.o., në të cilin emërohet “Teoren” shpk si distributor zyrtar në Shqipëri; certifikata ISO për sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit në emër të “Teoren” shpk; deklarata të konformitetit të BE-së për materialet elektrike; por jo një autorizim të drejtpërdrejtë nga Teoren shpk në favor të BOE-së, siç parashikon neni 2.3.11 i DST. Sipas dokumenteve të tenderit (pika 2.3.11), autoriteti kontraktor ka kërkuar që për mallrat e listuara, përfshirë materialet elektrike, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit ose autorizim nga distributori i autorizuar prej prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, që të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose ofertues-distributor-prodhues. Kjo kërkesë është e lidhur ngushtësisht me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit për të siguruar furnizimin dhe garancinë për materialet e ofertuara. Megjithatë, nga interpretimi sistematik i këtij kriteri, kuptohet se legjislacioni i prokurimit publik nuk kufizon format e dokumentacionit për të vërtetuar lidhjen ndërmjet aktorëve të zinxhirit të furnizimit, për aq kohë sa dokumentacioni i paraqitur arrin qëllimin e përcaktuar, pra të provojë burimin zyrtar të furnizimit dhe garancinë e përputhjes me standardet teknike. Edhe pse mungon një autorizim i drejtpërdrejtë i Teoren për BOE-në, është e rëndësishme të theksohet se autorizimi i prodhuesit NOARK për “Teoren” shpk është i vlefshëm dhe i qartë, duke e emërtuar këtë të fundit si distributor ekskluziv dhe të autorizuar për përfaqësimin e produkteve në prokurime publike në Shqipëri. Duke qenë se Teoren shpk është distributori i vetëm i autorizuar për NOARK në Shqipëri, dhe BOE ka paraqitur certifikata cilësie dhe konformiteti për materialet që lidhen me këtë distributor, krijohet një indici serioze dhe dokumentare që vërteton se materialet e ofertuara burojnë realisht nga prodhuesi përmes distributorit të tij zyrtar. Kjo indici e mbështetur nga dokumente zyrtare justifikon nevojën për sqarim dhe jo për skualifikim të menjëhershëm, në përputhje me nenin 78 të Ligjit nr. 162/2020, i

cili i jep autoritetit kontraktor të drejtën dhe detyrimin për të kërkuar sqarime në rastet kur ka dyshime ose mungesë të plotë të informacionit. Në përputhje me nenin 78, pika 3, të Ligjit për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë sqarime për dokumentet e paraqitura, përfshirë nëse një dokument është i paqartë, jo i plotë apo kërkon konfirmim të lidhjes ndërmjet operatorit dhe furnitorit. Në këtë rast, ekzistojnë elementë të mjaftueshëm që sugjerojnë një marrëdhënie të tërthortë bashkëpunimi, për të cilën është e arsyeshme që KVO të kishte kërkuar sqarim nga BOE, në vend që të ndërmerre skualifikim të drejtpërdrejtë. Parimi i proporcionalitetit, i sanksionuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, kërkon që kriteret për kualifikim të jenë jo vetëm të qarta dhe objektive, por edhe të zbatohen në mënyrë të arsyeshme dhe të matur në raport me qëllimin që synojnë të arrijnë. Qëllimi i pikës 2.3.11 nuk është të penalizojë ofertuesin për formën e autorizimit, por të sigurojë që autoriteti kontraktor të jetë i bindur për origjinën, cilësinë dhe garancinë e furnizimit të materialeve. Nëse dokumentacioni i paraqitur arrin këtë qëllim në mënyrë të tërthortë, përmes një zinxhiri të besueshëm logjik e dokumentar, atëherë mosparaqitja e një autorizimi të drejtpërdrejtë nuk duhet të çojë automatikisht në skualifikim, pa një kërkesë paraprake për sqarim. Në përfundim, BOE ka paraqitur një paketë dokumentacioni të vlefshëm, që përmban një autorizim të qartë nga prodhuesi për distributorin (Teoren), certifikata ISO dhe deklarata CE të vlefshme, të cilat krijojnë indicie të qarta të burimit të ligjshëm të furnizimit. Autoriteti kontraktor, përpara marrjes së vendimit për skualifikim, duhej të kishte kërkuar një sqarim të thjeshtë dokumentar nga BOE lidhur me ekzistencën e një marrëveshjeje me Teoren apo burimin real të furnizimit, në zbatim të nenit 78 të ligjit. Mungesa e këtij sqarimi përbën një mangësi procedurale nga autoriteti kontraktor, që mund të cenojë proporcionalitetin dhe rregullsinë e vendimit për skualifikim. Rekomandohet rishqyrtimi i vendimit të skualifikimit dhe kerkimi i sqarimit të nevojshëm nga BOE, përpara konfirmimit përfundimtar të skualifikimit. Sa më sipër pretendimi i BOE “Eral Construction Company” SHPK & “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK qëndron.

Si rrjedhojë e arsyetimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 34, 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjykoj:

- Të pranohet ankesa e bashkimit të operatorëve ekonomik “Eral Construction Company” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Caushi M” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34685-12-26-2024, me objekt “Ndertim i ujesjellesave te fshatrave FusheBardhe dhe Zhulat, Bashkia Gjirokaster” me fond limit 248,188,809.90 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SH.A.

Anëtar
Kreshnik Ternova

